



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 31 korrik 2014, në mbledhjen e VIII-të(tetë) të Kuvendit.

Mbledhja filloi në orën 10:05' dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit përveç z. Islam Revuçit, z. Ismajl Krasniqit dhe z. Mirsad Kamerollit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm, z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, z. Agim Kikaj, Nënkryetar i Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, z. Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

Të pranishëm, në cilësinë e mysafirëve në këtë seancë ishte edhe delegacioni prej tre përfaqësuesve të Qytetit të Westerstedes të Republikës së Gjermanisë, në krye me z. Klaus Gross, Kryetar i Qytetit të Westerstedes.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, në fjalën hyrëse për këtë mbledhje theksoi, të nderuara, këshilltare dhe këshilltarë të Kuvendit, i nderuari, z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës, i nderuari Nënkryetar i Komunës, dhe drejtorë të Drejtorive komunale, më lejoni që në emrin tuaj dhe në emrin tim personal, t'i përshëndes mysafirët e nderuar nga Qyteti i Westerstedes të Republikës së Gjermanisë, të cilëve njëherit ju dëshiroj mirëseardhje.

Këshilltarë të nderuar, kemi nderin që në këtë mbledhje i pranishëm është delegacion nga Qyteti i Westerstedes të Republikës së Gjermanisë në krye të të cilit është zotëri Klaus Gross Kryetar i Qytetit Westerstede. Ju njoftoj, se kjo vizitë është vazhdim i vizitave të ndërsjella në funksion të identifikimit për bashkëpunim në mes Qyteteve, Westerstede dhe Komunës së Podujevës.

Jeni në dijeni se z. Agim Veliu Kryetari i Komunës së Podujevës, me një delegacion ku kam pasur fatin të jem edhe unë, në mars të vitit 2012, ishim në një vizitë pune në Qytetin e Westerstedes ku u pritëm ngrohtësisht nga përfaqësues të institucioneve të këtij Qyteti e në veçanti nga Kryetari z. Klaus Gross.

Edhe njëherë në emër të Kuvendit të Komunës e falënderoj delegacionin nga Westerstede për këtë vizitë dhe e ftoj të nderuarin Klaus Gross, të merr një fjalë rasti.

z. Klaus Gross, Kryetar i Qytetit Westerstede të Republikës së Gjermanisë, theksoi, i nderuari i Kryetarë i Komunës së Podujevës, i nderuari Kryetar i Kuvendit të Komunës së Podujevës, të nderuar këshilltare dhe këshilltarë të Kuvendit të Komunës, keni përshëndetje të ngrohtë nga unë në cilësinë e Kryetarit të Qytetit të Westerstedes.

Me këtë rast dëshiroj t'ju falënderoj edhe një herë shumë zemërsisht, sidomos për mikpritjen e juaj të cilën ende nuk e kam hasur ndokund, e që ne Gjermanët nuk mund t'jua bëjmë një mikpritje të tillë ashtu siç e bëtë ju për ne.

Së pari, unë nuk kam ardhur këtu vetëm si Kryetar i Këshillit Bashkiak të Qytetit të Westerstedes, mirëpo në rend të parë jam një mik i juaji dhe në veçanti një mik i madh i Kryetarit të Komunës tuaj z. Agim Veliut.

Me mua, pjesë e delegacionit është znj. Wilma Eberlei, Drejtoresh për Arsim në qytetin tonë dhe në rrethin e Ammerlandit në përgjithësi, do të thotë se po shihet se në Gjermani gjithherë kanë më shumë gratë të flasin dhe të vendosin gjëra, e kjo shihet edhe nga z. Angela Merkel, e për këtë e kam marrë edhe unë Drejtoreshën e Arsimit, gjithashtu unë në delegacion e kam edhe njeriun më të vjetër të Kuvendit të Komunës së Westerstedes për të cilin jam shumë i kënaqur që është pjesë e këtij delegacioni z. Karl-Fritz Gertjeanssen, i cili është nga Partia e të Gjellbërve, dhe që i falënderohem shumë sepse kujdeset shumë për ambientin tonë, por që të njëjtën kohë është edhe shef i një firme mbi 100 vjeçare.

Ne jemi ardhur në këtë vizitë, pas vizitës që na ka bërë delegacioni juaj në krye me z. Agim Veliun, Kryetar i Komunës, kemi pasur dëshirë që vizitën ta bëjmë kohë më parë por për arsye objektive nuk kemi mundur ta bëjmë këtë, mirëpo tani kemi ardhur me gjithë dëshirë që t'ju vizitojmë juve dhe të shohim se çka mund të bëjmë qyteti i Westerstedes dhe Komuna e Podujevës bashkërisht. Ne jemi ndryshe të organizuar dhe kemi tjetër rregullim shtetërorë, dhe të njëjtën kohë ne kemi shumë një fat të mirë që nuk vijmë nga një luftë apo nga një sistem tjetër siç keni qenë ju edhe pse në këtë rast kemi bashkimin me Republikën Demokratike, mirëpo prapë se prapë ne bashkimin e kemi bërë me paqe dhe nuk kemi pasur nevojë që t'i përjetojmë ato që i keni përjetuar ju. Unë sot kam ardhur këtu, por është shumë vështirë për mua të them sot se çka do të bëjë konkretisht, sepse bazohem në gjyshin tim i cili po ashtu ka qenë Kryetar i qytetit e cili më ka thënë se idetë janë shumë të mira por janë edhe më të mira atëherë kur realizohen në praktikë, pra do të thotë se edhe kjo është ideja ime që këto ide të cilat i kam për Komunën e Podujevës në bashkëpunim me Westerstedën në të ardhmën t'i vendosim në praktikë dhe mos të mbeten vetëm si ide.

Jemi në dijeni që ju para 15 viteve keni përjetuar një ngjarje e cila nuk është lehtë të harrohet, mirëpo porosia ime dhe të gjithëve është që të shikohet e ardhmja, dhe me këtë rast me ndihmën e Kryetarit të Komunës dhe Kryesuesit të Kuvendit të shikoni vetëm të ardhmen dhe mos të shikoni të kaluarën, nuk them që t'i harroni por të fokusoheni në të ardhmen, prandaj unë dhe qyteti im me aq sa ka mundësi do t'ju ndihmoj. Për ne ishte një nderë që Kryetari i Komunës së Podujevës me delegacionin e tij vizitoi Westerstedën ku ne kishim shansin t'iu tregojmë se si funksionon Komuna jonë në aspektin ekonomik ashtu edhe në aspektin politikë dhe shumë gjëra të tjera, mirëpo edhe ne kemi shansin të mësojmë dhe të shohim nga ju, dhe me siguri se në bazë të këtyre do të shikojmë se çka do të bëjmë në të ardhmen.

Qyteti i Westestedes ka 22,000 banorë, mirëpo ne jemi me një strukturë ndryshe ngase në rrethin tonë funksionojnë gjashtë Komuna, si dhe strukturën tjetër ngase 33% e të ardhurave tona sigurohet nga të ardhurat tatimit. Bashkëpunimi jonë me ato Komuna është i shkëlqyer, pra nuk është rasti si në Kosovë ku organizimi është tjetër, përveç 33% të të ardhurave që i sigurojmë nga tatimi, ne të ardhurat tjera i sigurojmë nga të gjitha firmat të cilat veprojnë në rrethin tonë të cilat janë të detyruara që një pjesë të

fitimit të tyre ta japin për qytetin e Westerstedes, mirëpo në rast se ndahet buxheti dhe të gjitha këto të hyra nuk mjaftojnë për buxhetin vjetor, të gjitha të hyrat tjera vijnë nga rrethi i Ammerlandit, ngase siç e dini shteti i Gjermanisë përbëhet nga disa Republika.

Tani është viti i 13-të që jam Kryetar i Bashkësisë së qytetit Westerstede, dhe pse jemi si qytet nëse i nevojitemi ndokujt jemi shumë solidar ku kemi një font të veçantë për raste të tilla apo raste për t'i ndihmuar ndokujt që ka nevojë për ne.

Sot kam sjellë një CD ku mund të shihni ju si Kuvend i Komunës kur të gjeni kohë, se si inkasohen të ardhurat dhe krejt çka bëhet dhe si zhvillohet jeta në qytetin tonë.

Ju e keni një përparësi të cilën rrallë kush apo se ka askush atë përparësi, që populli juaj është shumë i ri në moshë, ndërsa te ne është e kundërta ku mbi 60% e popullsisë është mbi 60 vjeçare, andaj edhe pse jeni në fillim të demokracisë sigurisht se do t'i arrini shumë gjëra, ndërsa për ne është një përgjegjësi shumë e madhe sepse tani është duke u vjetërsuar popullsia gjë e cila është shumë e kushtueshme, por të cilën ne duhet që ta financojmë, mirëpo prapë se prapë ne jemi përgjegjës para atyre njerëzve ngase ata janë të cilët e ndërtuan shtetin tonë dhe ata janë që na sollën në këtë pozitë të cilën jemi sot, prandaj për këtë jemi të detyruar moralisht dhe detyrimisht të kujdesemi për ata persona qoftë në aspektin shëndetësorë apo çfarëdo aspekti tjetër.

Ju keni një përgjegjësi që gjeneratat e reja t'i shkolloni dhe t'ju jepni një mundësi që edhe nëse dalin në shtete tjera të shkollohen, mirëpo secili që shkollohet në vende të tjera duhet ta ndien atë përgjegjësi që të kthehet prapë dhe të ndihmon në zhvillimin e atdheut të tij dhe tuajin, e ju keni në rast të tillë siç është z. Sami Vokrri.

Gjatë vizitës sonë që kemi filluar është një pyetje e cila tërë kohën më sillet në kokë, ku do t'ia fillojmë, çka do të fillojmë dhe si do t'i ndërmarrim hapat e parë për t'iu ndihmuar juve, mirëpo për këtë do të shohim bashkërisht me Kryetarin e Komunës tuaj se çka do të bëjmë, do të thotë, do të formojmë së bashku me Kryetarin e Komunës së Podujevës një plan të veçantë në formë të masterplanit dhe do të shikojmë çdo pikë se çka mund të bëjmë bashkërisht Westerstede dhe Podujeva. Një ditë më parë ishim në një vizitë në fabrikën Agroprodukt Commerce e cila merret me prodhimin e mjedrave dhe produkteve tjera, dhe tani për këtë e kam idenë se çka do të bëjmë për plasmanin e tregut të saj dhe do të mundohemi me të gjitha mundësit dhe kushtet që kemi ta ndihmojmë, këtë vit ose vitin e ardhshëm do të ftoj një delegacion të Komunës tuaj në krye me Kryetarin e Komunës që kësaj radhe ta hartojmë një plan ekonomik se çka mundet qyteti i Westerstedes të bëjë për Komunën e Podujevës në gjitha aspektet.

Pra edhe një herë potencoj se jam shumë i kënaqur për mikpritjen e juaj dhe të Kryetarit të Komunës të cilin e falënderoj shumë, çdo gjë ka shkuar në rregull deri tani.

Rrethi i qytetit të Westerstedes është pothuajse kryesori dhe superfuqi Evropiane por edhe në Botë për prodhimin e luleve ku janë të punësuar mbi 1500 punëtorë dhe kemi lulishten e dytë më të madhe në botë, pra kjo është shumë e rëndësishme për ne sepse prodhojmë vende të punës dhe mbi të gjitha personat me nevoja të veçanta mund të punësohen në lulishten e qytetit të Westerstedes, ne në çdo katër vite organizojmë një panair të lulishtes ku është një ndër panairët kryesore në Evropë, me q'rast presim mbi 100,000 turist gjë e cila për qytetin tonë është shumë e rëndësishme sepse nga kjo varet zhvillimi jonë i mëtutjeshëm dhe prodhon dhe riprodhon vende të reja të punës, por kryesorja është se kemi bashkëpunim shumë të mirë me qytetarë, panairi mbahet në këtë vit dhe çanta e parë që i jepet dikujt në lidhje me panairin është kjo e cila do ia dhuroj z. Agim Veliut, Kryetarit të Komunës së Podujevës, por dhe një çantë do t'ja

dhuroj edhe drejtorit të Drejtorisë së Arsimit z. Nexhmi Rudarit, ngase ka të bëjë me shkollën (i dhuron këto dhurata).

Ju falënderoj shumë për durim që shfaqët për të më dëgjuar, mirëpo ju falënderoj edhe për përkrahjen e juaj për reprezentacionin e futbollit Gjerman i cili fitoi kupën e botës ku në ekip ishte edhe një Kosovar. Gjithashtu edhe për këshilltarët e Kuvendi kam nga një dhuratë, dua t'jua dhuroj nga një simbol me stemën e qytetit të Westerstedes dhe nëse ndokush nga ju ka rastin të vijë ndonjëherë në qytetin tonë, mund të hyni me këtë simbol në Komunë pa ju ndalur askush.

Pra ne tani do ju lëmë të vazhdoni me punë ju si Kuvend i Komunës, ndërsa ne do vazhdojmë vizitat tona të parapara.

(kjo fjalë rasti është shkruar në bazë të përkthimit simultant)

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, falënderoj shumë z. Klaus Gross, Kryetar i Qytetit Westerstede për këtë fjalë rasti dhe për këto fjalë shumë miqësore, si dhe asistentin-përkthyesin z. Sami Vokri. Gjithashtu shprehi falënderim të veçantë për këtë vizitë të delegacionit që i bënë Kuvendit të Komunës, por falënderoj edhe këshilltarët e Kuvendit dhe gjithë pjesëmarrësit tjerë për pritjen që bëmë delegacionit nga rrethi i qytetit Westerstede nga Gjermania.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi,ne një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa i kemi shqyrtuar këto pika të rendit të propozuar të ditës por kemi pasur edhe disa çështje për të cilat i kemi rekomanduar Kuvendit që të përfshihen në rendin e ditës, përkatësisht të plotësohet me këto pika;

- Në kuadër të pikës së gjashtë të rendit të propozuar të ditës të përfshihet edhe një kërkesë nga Muharrem Isufi nga Fshati Majac, për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, kërkesë e cila është paraqitur pasi është dërguar materiali i kësaj mbledhjeje.
- Plotësimi i rendit të ditës në pikën shtatë, Rishqyrtimi i vendimit nr.01-119-61160 i miratuar në Kuvendin e Komunës më datë 18 korrik 2014, për kompensimin e punëve dhe angazhimeve të Komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane,shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës, vendim në të cilin gjatë procedurës së votimit kemi bërë një lëshim ku kemi votuar edhe ne të cilët jemi anëtarë të atij Komisioni gjë që paraqet konflikt interesi, mirëpo këtë e ka vërejtur Kryetari i Komunës dhe ka kërkuar që vendimi përkatës të kthehet në rishqyrtim.
- Dhe kemi një propozim vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim, propozim i cili është bërë për shkak se ne si Kuvend e kemi themeluar komisionin vlerësues për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim i cili ka filluar me vlerësimin e disa ofertave por parashihet të jetë edhe komisioni përkatës në rast të ndonjë ankese.

z. Kadri Avdiu, theksoi, ne në mbledhjen e KPF-së kemi kërkuar një informatë nga Ekzekutivi i Komunës rreth çështjes që ka të bëjë me Obeliskun Afrim Zhitia, se çfarë është bërë deri më tani, dhe çështja e dytë ka qenë informatë rreth fillimit të ndërtimit të shkollës në fshatin Batllavë, çështje e cila për ne është e papranueshme që të fillon ndërtimi i shkollës në një lokacion të pa miratuar nga Kuvendi i Komunës dhe të anashkalohet lokacioni ku ishte shkolla e mëparshme, si dhe të vijë deri te një konflikt nga banorët e atij fshati ku është dashur të ndërhyj edhe policia, ndërsa ne si Kuvend marrim informacione vetëm nga persona në rrugë, dhe unë nuk kuptoj se si është bërë marrëveshja me MASHT-in për ndërtimin e asaj shkolle në atë lokacion pa pasur vendim nga Kuvendi për caktimin e lokacionit, çështje për të cilat kemi kërkuar të futen në rend dite për këtë mbledhje por që në konstatime të Komitetit për Politikë dhe Financa nuk figurojnë por kërkojmë prapë të përfshihen këto dy pika ngase janë të rëndësishme.

z. Xhevdet Beselica, theksoi, Kuvendi i Komunës e ka ngritur komisionin vlerësues për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, andaj kërkoj që sot të përfshihet në rend dite puna e komisionit dhe procedura e ofertimit dhe të diskutojmë se si janë dhënë disa prona të Komunës në shfrytëzim, me çfarë ofertash dhe në çfarë formash janë dhënë ato prona si dhe kush janë ofertuesit, e them këtë ngase ka zëra se nuk janë përfillur procedurat e tenderimit ku ka pasur të interesuar që t'i shikojnë ato prona dhe nuk janë hapur ato prona, kështu që propozoj të futet në rend dite kjo çështje dhe të diskutohet, dhe të njëjtën kohë të na sqarojnë anëtarët e tri grupeve të këshilltarëve të cilët janë anëtarë të komisionit përkatës, se si janë përzgjedhur fituesit e atyre pronave.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, unë vetëm desha të shfaq një pakënaqësi timen sepse para tri seancave i kam ngritur tri çështje për të cilat kam kërkuar informacion dhe që nuk kam marrë asnjë informacion, fjala është për Drejtorinë e Arsimit, rreth organizimeve të mbrëmjeve të maturës se a ka pasur oferta nga bizneset të cilat operojnë në territorin e Komunës tonë dhe me çfarë çmimesh kanë qenë ato, si dhe me çfarë çmimesh janë vendosur mbrëmjet e maturës, çështje tjetër ka qenë rreth tri ndërmarrjeve publike për të cilat tani drejtori i Drejtorisë përkatëse më njoftoj se e ka raportin të gatshëm sot dhe do të procedoj, dhe çështja e tretë që kam kërkuar se me cilën bazë policia i shoqëron ndërmarrjet publike si dhe tani edhe atë private KEDS për inkasimin e borxheve nga qytetarët tanë ku pa asnjë urdhëresë hynë në shtëpi të njerëzve duke cenuar privatësinë e tyre.

Ndërsa rreth komisionit për dhënin e pronave të Komunës në shfrytëzim, desha të parashtroj pyetje se a ka akte nënligjore të mjaftueshme, në cilin akt ky komision e mbështet punën e vet dhe në bazë të cilit akt vendosin t'i japin ato prona të Komunës tonë në shfrytëzim.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kërkoj nga këshilltarët që pyetjet e tyre për Ekzekutivin t'i parashtrojnë në pikën të ndryshme sepse ashtu parashihet me Rregullore të Punës së Kuvendit, kërkoj ndjesë që disa përgjigje nuk janë dhënë nga drejtorët e Drejtorive ende dhe kërkoj nga ata që në të ardhmen t'ju përgjigjen pyetjeve të këshilltarëve. Ndërsa disa çështje të cilat u potencuan deri tani mendoj se nuk janë për tu përfshirë në rend dite si pika të veçanta por vetëm të kemi informata në pikën të ndryshme. Lidhur me lokacionin për ndërtimin e shkollës në fshatin Batllavë nuk mund të japim informacion tani ngase drejtori i Drejtorisë së Arsimit nuk është prezent këtu për shkak se është i zënë në vizita me delegacionin e Westerstedes, kurse për çështjen e

Obeliskut mendoj se drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë në të ndryshme do të na jap një informatë, ndërsa sa i përket asaj që e shtroi z. Xhevdet Beselica mendoj se sot nuk kemi informata dhe material të mjaftueshëm për ta përfshirë në rend dite çështjen e dhënies së pronave të Komunës në shfrytëzim, ndërsa çështjet të cilat i përmendi z. Lutfi Rexhepi, unë kam kërkuar nga Zyra ligjore që të gjitha pyetjet t'i adresojnë në Drejtori përkatëse dhe mendoj se në mbledhjet e ardhshme do të kemi përgjigje nga drejtorët e Drejtorive përkatëse.

z. Haki Rudari, theksoi, më 02.07.2014 në këtë Kuvend është debatuar për gjendjen e rëndë në Lagjen e Dëshmorëve, andaj kërkoj nga Ekzekutivi i Komunës që të na japin një informatë për atë Lagje, dhe pyes se a është vizituar nga Ekzekutivi i Komunës ajo Lagje dhe çka është ndërmarrë dhe çka është vepruar deri më tani në Lagjen e Dëshmorëve, lagje për të cilën jemi pajtuar se vërtetë është në gjendje të vështirë.

Çështje tjetër të cilën dua të ngritë dhe për të cilën është duke u bërë shumë zhurmë që një kohë të gjatë e që Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së me kohë e ka dhënë mendimin e vet lidhur me çështjen që ka të bëjë me Obeliskun Afrim Zhitia ku kemi thënë se duhet të implementohet ligji, ndërsa nga dikush tjetër ndoshta ka pasur prolongime në këtë aspekt, andaj kërkoj nga Drejtoria përkatëse që të na informoj për anën ligjore se deri ku ka mbërri çështja e ndërlidhur me Obeliskun, në mënyrë që ne të jemi të përgatitur sa më shumë. Pra për këto dy çështje kërkoj të kemi informata nga Ekzekutivi i Komunës.

z. Kadri Avdiu, theksoi, Kryesuesi e tha se duhet të respektohet Rregullorja e Punës së Kuvendit dhe ligjet tjera, andaj kam vërejtje sepse unë edhe në mbledhjen e KPF-së por edhe këtu sot kërkoja që të përfshihen në rend dite dy pikat përkatëse, ndërsa ju zotëri Kryesues thoni që të ketë vetëm një informatë në pikën të ndryshme, prandaj konsideroj se duhet të përfillen rregullat dhe të qiten në votim ato dy pika që unë i propozova.

z. Vehbi Rushiti, theksoi, lidhur me kërkesën e z. Kadri Avdiut që të futet në rend dite dhe të diskutohet për çështjen e lokacionit për ndërtimin e shkollës në fshati Batllavë unë mendoj se kjo çështje nuk na përket neve si këshilltarë të Kuvendit ngase mosmarrëveshjet dhe interesat ekzistojnë mes banorëve të fshatit Batllavë për të caktuar lokacionin për ndërtimin e shkollës së re në atë fshat, gjithashtu të gjithë ne jemi në dijeni se projekti për ndërtimin e shkollës së re në fshatin Batllavë vitin e kaluar është bartur në fshatin Siboc ku edhe është ndërtuar shkolla, shkak për këtë kanë qenë ato mosmarrëveshje mes banorëve të Batllavës, andaj konsideroj se nuk kemi çka të debatojmë ne sot këtu për atë çështje ngase disa banorë të fshatit Batllavë nuk dëshirojnë që shkolla të ndërtohet në atë fshatë apo në lokacionin përkatës dhe nuk mund të merren vesh për lokacion. Për të njëjtin problem para disa viteve Komuna e Podujevës pati humbur edhe donacion për ndërtimin e shkollës në fshatin Lupç duke mos u marr vesh banorët e atij fshati mes vete.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së nuk jemi për të mos diskutuar për çështjet të cilat u ngritën, mirëpo ashtu siç e tha edhe Kryesuesi i Kuvendit, për çështjen e Obeliskut kemi diskutuar edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa se është çështje procedurale, për lokacionin e ndërtimit të shkollës në fshatin Batllavë drejtori i Drejtorisë së Arsimit nuk është prezent në këtë mbledhje, ndërsa për mënyrën e dhënies në shfrytëzim të pronave të Komunës ne duhet të kemi një raport dhe materiale tjera për të diskutuar për atë çështje ngase nuk kemi informata të mjaftueshme sot. Pra unë kërkoj që të hedhet në votim rendi i ditës ashtu siç e kemi

miratuar dhe siç i kemi rekomanduar Kuvendit në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në fillim të mbledhjes ishte një nderë që qëndruan një delegacion nga qyteti i Westerstedes të Gjermanisë, mirëpo më bërë përshtypje që ishte një tremë nga Kuvendi i Komunës dhe u ndryshua renditja e debatit ku në pikën e parë e keni renditur të katërtën në mënyrë që nëse është prezenca e delegacionit përkatës të mos debatohet, dhe nuk është në rregull që të përsëriten shkeljet të cilat i keni bërë në seancën e kaluar, ku në këtë rend dite futen, propozimi i vendimit për destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore i cili ka ardhur si material shtesë, dhe rishqyrtimi i vendimit të mbledhjes së kaluar ku keni dhënë votë vetvetes Kryesuesi i Kuvendit dhe anëtarët tjerë të komisionit përkatës nga radhët e LDK-së, ndërsa lihet pikë e tretë dhe katërt Raporti i Auditorit të përgjithshëm dhe Raporti financiar janar – qershor 2014.

Çështje tjetër, e që u tha se drejtori i Drejtorisë së Arsimit mungon në këtë mbledhje të Kuvendit ngase iu ka bashkëngjitur delegacionit, unë mendoj se thirrja për të bërë një raport për gjendjen në Arsimin e Komunës së Podujevës ka qenë para 4-5 seancave të kaluara, ndërsa sa i përket çështjes së ndërtimit të shkollës në fshatin Batllavë mendoj se duhet të debatohet ngase një ditë më parë ka pasur edhe arrestime në atë fshat në lidhje me lokacionin e ndërtimit të asaj shkolle ku janë arrestuar kryetari i nëndegës së LDK-së Qerimi bashkë me dy-tre aktivistë tjerë, sa i përket asaj që e tha z. Vehbi Rushiti, mendoj se ka qenë vullneti i komuniteti i fshatit për të ndërtuar shkollën por mos aftësia e Kuvendit të Komunës për të caktuar një lokacion ka qenë shkak dhe se nuk qëndron ajo që e tha këshilltari i cekur ngase ridestini i mjeteve nga projekti që ishte për fshatin Batllavë në fshatin Siboc ishte i paligjshëm sikurse që është e paligjshme edhe prona ku ka filluar tani pastrimi për të ndërtuar shkollën në fshatin Batllavë, për arsye se nuk ka vendim për ndërrim të destinimit të investimeve të mjeteve, do të thotë se mjetet financiare i ka ndarë Ministria përkatëse ndërsa përgjegjësi e Kuvendit të Komunës është të cakton lokacionin për të ndërtuar objektin e shkollës e që unë mendoj se jashtëligjshëm ka filluar ndërtimi i shkollës ngase nuk ka vendim të Kuvendit për ndërrim të destinimit, nuk ka parcelë kadastrale dhe është lokacion jo i përshtatshëm për zhvillim të arsimit ngase është afër xhamisë dhe thirret ozani 4-5 herë brenda orarit mësimor dhe që ka biznese të ndryshme afër të cilat pengojnë procesin mësimorë si dhe është mbi një lum për të cilin me siguri se do t'i vie radha të debatohet këtë vit, pra kërkoj që të thirret drejtori i Drejtorisë së Arsimit dhe të debatohet për këtë çështje, andaj të anashkalohet kjo çështje duke u arsyetuar siç e tha z. Vehbi Rushiti mendoj se është jo ligjore, gjithashtu unë kam një listë me rreth 300 nënshkrime të banorëve të fshatit Batllavë e cila është e protokolluar në Komunë në të cilën figuron edhe kryetari i nëndegës së LDK-së. Nëse për juve nuk është e rëndësishme që në atë fshat të ndodhë ndonjë incident i mundshëm pa dashjen e askujt por vetëm për interesa politike apo për interesa të komunitetit brenda fshatit, mendoj se është jo etike dhe jo morale që sot të mos ta votojmë përfshirjen e kësaj çështjeje në rend dite që të debatohet dhe të shikohet mundësitë e gjetjes së një rruge.

z. Naim Çunaku, theksoi, e filluam këtë seancë duke debatuar për rend dite dhe kur potencohet Rregullorja e Punës së Kuvendit këtë e vëmë shumë pak në funksion. z. Vehbi Rushiti e përmendi problematikën rreth ndërtimit të shkollës në fshatin Batllavë gjë që mendoj se në atë fshat qëndron një situatë jo e mirë ku raportet ndër njerëzore veç janë keqësuar dhe mund të vie deri te një situatë më e rëndë ku ne si Kuvend nuk do të kishim

mundur t'i ikim përgjegjësisë morale në qoftë se pason ndonjë akt ose ngjarje që do të mund të përkeqësonte situatën në atë lokalitet. Më vie mirë që pas afër dhjetë viteve u përmend humbja e donacionit për ndërtimin e shkollës në fshatin Lupç duke pasur konflikte gjegjësisht duke mos mundur të gjendet lokaliteti në atë fshat, dhe në atë kohë është thënë se nuk ka humbur donacioni, ndërsa tash pas gjithë këtyre viteve u pranua që donacioni kishte humbur ku pastaj Komuna është dashur të ndërtoj shkollën me mjete vetanake. Gjithashtu u përmend shkolla e fshatit Siboc, kur është mbyllur ajo shkollë për kushte jo të mira e që ne disa herë kemi kërkuar që të bëhet diçka për atë shkollë, në këtë Kuvend është thënë se ndërtimi i asaj shkolle nuk është në prioritet të Ekzekutivit për atë vit, ndërsa kur dështon marrëveshja për ndërtimin e shkollës në fshatin Batllavë ku nuk mund të merren vesh për lokacion dhe ne si Kuvend nuk kemi arritur të ndihmojmë të gjendet një lokacion, barten mjetet prapë pa vendim të Kuvendit ku futet në prioritet ndërtimi i shkollës së fshatit Siboc dhe ndërtohet ajo shkollë, gjë që është shumë mirë që është ndërtuar sepse ka qenë në gjendje të mjerueshme, por është shumë mirë që tani të bëhet diçka edhe për ndërtimin e shkollës në fshatin Batllavë ngase përgjegjësia bie mbi neve deshëm apo nuk deshëm ne, pra duhet të mundohemi të jemi në proces të arritjes së një marrëveshjeje në mes atyre qytetarëve në mënyrë që të ndahet një lokacion sepse caktimi i lokacionit është përgjegjësi e Kuvendit të Komunës, pa pasur pretendime por të ndërtohet aty ku është më e arsyeshme sepse fundja ne jemi përfaqësues të atyre qytetarëve dhe kemi për obligim të gjejmë një lokacion të arsyeshëm për ndërtimin e shkollës së re.

Gjithashtu, zotëri Kryesues, në fillim të mbledhjes z. Xhevdet Beselica nuk bëri pyetje por propozoi një çështje për përfshirje në rend dite për këtë mbledhje sikurse edhe z. Kadri Avdiu propozoi që çështja që ka të bëjë me Obeliskun të përfshihet në rend dite, pra Rregullorja e Punës së Kuvendit ia mundëson çdo këshilltari të Kuvendit por edhe ju zotëri Kryesues i Kuvendit ta shtoi rendin e ditës, dhe këshilltarët kanë të drejtë të propozojnë të shtohet rendi i ditës me ndonjë pikë të veçantë, hedhet propozimi në votim dhe nëse kalon me vota futet në rend dite nëse jo vazhdojmë, andaj nuk kemi çka debatojmë për këtë çështje, dhe fundja nuk është mirë që të lejohet debat për rend dite ngase është në kundërshtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit, unë edhe mbledhjen e kaluar e kam thënë se është mirë që këshilltarët ta kenë në formë të shkruar një broshurë apo Rregulloren në tërësi në mënyrë që të mos thirremi në Rregullore ndërsa në anën tjetër shkelet kjo Rregullore.

z. Shaban Osmani, theksoi, kam vërejtje në ju zotëri Kryesues i Kuvendit, ngase së pari duhet të hedhet në votim rendi i propozuar i ditës i cili na u është dërguar neve si këshilltarë dhe nëse miratohet vazhdohet votimi për pikat tjera të propozuara si pika të veçanta për rend dite. Sa i përket propozimeve që u bënë nga parafolësit konsideroj se është më mirë të përfshihen në kuadër të pikës të ndryshme ndërsa në mbledhjen e radhës të debatohet për këto propozime. Pra sot në këtë mbledhje duhet që të debatojmë për pikat që janë në rendin e propozuar të ditës sipas dërgimit të materialit, dhe në mbledhjen e radhës të kemi raportin e Drejtorisë së Arsimit, ndërsa drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë është këtu prezent dhe mund të na informoi për çështjen e Obeliskut Afrim Zhitia se deri në cilën fazë procedurale ka mbërri. Pra edhe një herë po e përsëris, të hedhet në votim rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes së mbledhjes dhe nëse miratohet vazhdojmë, nëse jo atëherë e zgjerojmë me pika shtesë, si dhe të respektohet koha e diskutimeve ashtu siç është e rregulluar me Rregullore.

z. Naim Çunaku, theksoi, nga parafolësi u përmend Rregullorja e Punës së Kuvendit, ndërsa unë them se me këtë Rregullore i lejohet secilit këshilltar që kurdo që shkelet Rregullorja e Punës së Kuvendi ka të drejtë të merr fjalën, dhe unë në këtë rast mora fjalën të flas për Rregulloren zotëri Kryesues i Kuvendit. Si procedohet me rend dite po e përsëris që është mirë që të kemi Rregulloren përpara ku prej nenit 33 deri te neni 37.2 rregullohet se si miratohet rendi i ditës, e që në një prej tyre thotë, në rendin e ditës të propozuar, çdo këshilltarë, Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit kanë të drejtë të propozojnë pikë shtesë, dhe për pikën shtesë së pari deklarohet Kuvendi, pasi të merr miratimin apo refuzimin nga Kuvendi, shkohet me procedim të rendit të ditës ashtu si është i përcaktuar, nëse miratohet pika shtesë e rendit të ditës apo hiqet ndonjë pikë nga rendi i ditës del komplet propozimi i rendit të ditës para këshilltarëve, kurse në mbledhjen e kaluar ne e kemi miratuar një propozim shtesë për rend të ditës por rendin e ditës në tërësi nuk e kemi miratuar fare.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, është e vërtetë që ka raste ku shkelet Rregullorja e Punës së Kuvendit ngase në vend që të bëhen propozime konkrete, bëhen diskutime dhe debate me minutash më të gjatë se që parashihet me Rregullore, pa u miratuar rendi i ditës. por para se të votojmë e ftoj z. Abaz Llugaliun drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë të na jap një informatë të shkurtë për procedurat ligjore që kanë të bëjnë me çështjen e Obeliskut.

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, çështja që lidhet me Obeliskun Afrim Zhitia është vendosur në Agjensionin Kadastral të Kosovës, aktvendimi i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë është marrë, palët kanë hapur konflikt administrativ dhe lënda është në Gjykatën Themelore – Departamentin për konflikte administrative. Agjensioni Kadastral i Kosovës iu ka dhënë palëve afat prej 30 ditëve për ankesë në mjetin juridik, e drejtë e cila është shfrytëzuar nga palët të cilat iu kanë drejtuar Gjykatës Themelore – Departamentit për konflikte administrative, pra kjo ishte sa i përket çështjes së Obeliskut.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, për të gjitha këto propozime që u bënë unë nuk e shoh të arsyeshme që të debatohet por vetëm të kemi nga një informatë për shkak se nuk kanë përfunduar procedurat përkatëse, ndërsa sa i përket çështjes që ka të bëjë ndërtimin e shkollës në fshatin Batllavë, drejtori i Drejtorisë së Arsimit nuk është prezent në këtë mbledhje.

Andaj edhe një herë e përsërisë, se secilin propozim që u bë këtu sot nga këshilltarët e hedh në votim, duke filluar me propozimin e z. Kadri Avdiut, për përfshirje në rend dite për këtë mbledhje si pikë e veçantë çështja që ka të bëjë me Obeliskun Afrim Zhitia.

Pas votimit u konstatua se me 14 vota për, 16 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, nuk miratohet ky propozim për tu përfshirë në rend dite si pikë e veçantë çështja që ka të bëjë me Obeliskun Afrim Zhitia.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, tani e hedh në votim propozimin e dytë nga z. Kadri Avdiu për përfshirje në rend dite për këtë mbledhje si pikë e veçantë çështja që ka të bëjë me ndërtimin e shkollës së re në fshatin Batllavë.

Ne nuk jemi kundër debatit për këtë propozim por meqë nuk është prezent në këtë mbledhje drejtori i Drejtorisë së Arsimit konsideroj se nuk mund të debatojmë, andaj edhe votojmë kundër.

Pas votimit u konstatua se me 14 vota për, 14 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, nuk miratohet ky propozim për tu përfshirë në rend dite si pikë e veçantë çështja që ka të bëjë me Obeliskun Afrim Zhitia.

(ky propozim nuk kalon duke u bazuar në votën shtesë të Kryesuesit të Kuvendit në rast të numrit të votave të barabarta, votë të cilën Kryesuesi e dha kundër)

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, pati edhe një propozim nga z.Xhevdet Beselica i cili kërkoi të përfshihet në rend dite si pikë e veçantë çështja që ka të bëjë me dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, përkatësisht kërkoi një raport nga komisioni për vlerësimin e ofertave për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, propozim për të cilin pati interesim edhe nga z. Lutfi Rexhepi, që të debatohet në këtë mbledhje.

Pas votimit u konstatua se me 14 vota për, 15 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur, nuk miratohet ky propozim për tu përfshirë në rend dite si pikë e veçantë çështja që e ngriti z.Xhevdet Beselica.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, tani e hedh në votim rendin e propozuar të ditës duke plotësuar me tri pikat shtesë të rekomanduara nga Komitetit për Politikë dhe Financa, përkatësisht;

- Në pikën gjashtë të rendit të ditës të përfshihet,propozimi i vendimit për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesës së Muharrem Isufit nga Fshati Majac.
- Rendi i propozuar i ditës të plotësohet me pikën shtatë, përkatësisht, Rishqyrtimi i vendimit nr.01-119-61160 i miratuar në Kuvendin e Komunës më datë 18 korrik 2014, për kompensimin e punëve dhe angazhimeve të Komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane,shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës.
- Gjithashtu rendi i propozuar i ditës të plotësohet me pikën tetë, përkatësisht, propozimi i vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim.

Pas votimit u konstatua se me 17 vota për, 12 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, miratohet rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe tri propozimet e rekomanduara sipas konstatimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 27 maj 2014

z. Haki Rudari, theksoi, opozita është e shqetësuar, jo për shkak të interesave personale por për shkak të interesave të qytetarëve, ku ne sot e kemi mbledhjen e tetë të Kuvendit të Komunës, kurse procesverbalin e kemi të mbledhjes së pestë gjë për të cilën mendoj se është kontrast mes vete, andaj për këtë kam vërejtje dhe shprehi një shqetësim timin si dhe apeloj që në mbledhjen e radhës të na dërgohen 2 procesverbalet e dy mbledhjeve të kaluara si dhe procesverbali nga kjo mbledhje që po mbahet sot, dhe kërkoj që në mbledhjet tjera të na dërgohen procesverbalet e mbledhjes paraprake. E them këtë ngase mos dërgimi me kohë i procesverbaleve ngjason në atë sikur kjo bëhet me qëllim dhe një far mënyre sikur po i humbë rëndësia procesverbaleve të mbledhjeve të Kuvendit, pra mendoj se kjo çështje që e shtrova duhet të merret parasysht dhe procesverbalet të na dërgohen sipas mbledhjeve paraprake e jo të ndodh sikurse tani që jemi në mbledhjen e tetë ndërsa kemi para vetës procesverbalin e mbledhjes së pestë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, mendoj se vërejtja që bëri parafolësi është vërejtje me vend, unë gjithë herë jam interesuar që procesverbalet e mbledhjeve të na dërgohen me kohë por për shkak të mbledhjeve shumë të gjata dhe angazhimeve tjera të zyrtarëve përkatës, nuk kanë mundur të përgatiten me kohë, mirëpo meqë në muajin gusht Kuvendi ka pushim shpresoj se do të jenë të gatshme të gjitha procesverbalet dhe do tu dorëzohen këshilltarëve së bashku me materialin e radhës, pra kjo vërejtje do të merret parasysht.

Nëse ndokush nga ju nuk ka ndonjë vërejtje konkrete, unë e hedh në vota Ekstraktin e procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 27 maj 2014.

Pas votimit u konstatua se njëzëri miratohet Ekstrakti i këtij procesverbali, me konstatim që në të ardhmen procesverbalet e mbledhjeve të dërgohen me kohë.

3. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne edhe një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi debatuar për këtë pikë të rendit të ditës dhe jemi sqaruar për çdo detaj nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave. Unë ju lus që sa i përket diskutimeve të respektohet Rregullorja e Punës së Kuvendit ku sipas saj së pari e merr fjalën hyrëse drejtori i Drejtorisë përkatëse që ndërlidhet me materialin përkatës, në këtë rast drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i cili i ka në dispozicion 10 minuta, pastaj shefat e Grupeve të këshilltarëve po ashtu 10 minuta dhe këshilltarët i kanë 5 minuta në dispozicion, ndërsa për diskutimin e dytë për të njëjtën pikë mund ta merr fjalën, në kohëzgjatje 2 minuta, çdo këshilltarë pas përfundimit të të gjitha diskutimeve. Pra për efikasitet më të mirë të punës së Kuvendit kërkoj të respektohen rregullat përkatëse.

z. Naim Çunaku, theksoi, është e vërtetë ajo që e tha Kryesuesi se si e përcakton Rregullorja e Punës së Kuvendit, mirëpo Rregullorja e jep mundësin që për pika të rëndësishme me vendim të Kuvendit të ndryshohet kohëzgjatja e debatit, do të thotë ky Kuvend mund të vendosë që të mos ketë përcaktim kohorë për pika të rëndësishme të rendit të ditës, dhe unë konsideroj se sot kemi një nga pikat më të rëndësishme për një vit financiar, që është Raporti i Auditorit të Përgjithshëm dhe Raporti financiar për gjashtëmujorin e këtij viti, andaj propozoj që për këto dy pika, pikën 3 dhe 4 të rendit të ditës, mos të ketë përkufizim kohorë në diskutimet e këshilltarëve të Kuvendit të Komunës. Këtë propozim e bëra për arsye se një numër i madh i këshilltarëve nuk e shfrytëzojnë gjithë herë kohën e diskutimeve të tyre siç përcaktohet me Rregullore, dhe nëse e aplikojmë kohën prej 5 minutave me siguri që do të mbesin diçka pa thënë, andaj meqë kemi këto dy pika mjaft të rëndësishme mendoj se duhet të thuhet të gjitha çka mendojnë këshilltarët, pra ky ishte propozim konkret.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, parafolësi e bëri një propozim që të mos ketë kufizime në kohë për diskutimet e këshilltarëve të Kuvendit për pikën 3 dhe 4 të këtij rendi të ditës. Për këtë unë konsideroj se mjaftojnë 5 minuta për t'i thënë të gjitha çdo këshilltarë për një pikë të rendit të ditës, por meqë ishte propozim konkret i bërë nga z. Naim Çunaku, unë e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se me 12 vota për, 15 vota kundër dhe 2 vota të përmbajtura, nuk miratohet propozimi i z. Naim Çunakut, i bërë për mos kufizim të kohës në diskutimet e këshilltarëve për pikën 3 dhe 4 të rendit të ditës për këtë mbledhje.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, vazhdojmë me punë, dhe ftoj drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave të paraqet fjalën hyrëse.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse për këtë pikë të rendit të ditës.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përshëndetim opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013 dhe konsiderojmë se është një opinion real, vlen të përshëndetet Ekzekutivi i Komunës për gatishmërinë e shfaqur për bashkëpunim me Auditorin e Përgjithshëm gjë e cila tregon një transparencë shumë të mirë të Ekzekutivit të Komunës. Bazuar në opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm për Komunën e Podujevës, është një opinion i pakualifikuar që është opinion i mirë i mundshëm, mirëpo Auditori i jap edhe disa rekomandime për të cilat mendojmë se Ekzekutivi i Komunës gjatë këtij viti do t'i ketë parasysh dhe do t'i përmirësoj ato.

z. Rafet Llapashtica, në emër të grupit të këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, theksoi, i dëgjuam dy parafolësit të cilët u shprehën të kënaqur me Raportin e Auditorit të Përgjithshëm, mirëpo me siguri se nuk i kanë lexuar gjetjet e Auditorit për Komunën e Podujevës. Duke u bazuar në këtë raport Kuvendi Komunal nuk ka arritur që t'i adresoi në mënyrë të plotë as 10% të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm që i ka dhënë në vitin 2012 për vitin 2013. Në bazë të gjetjeve nga Auditori i Përgjithshëm, Ekzekutivi i Komunës ka bërë shkelje ligjore duke bërë pagesa në kode të ndryshme ku nga kategoria e investimeve kapitale ka paguar për mallra dhe shërbime një shumë prej 88,104.00 €, shkelje tjetër apo jo në rregull është edhe mos raportimi me shkrim Kryetarit

të Komunës nga Drejtoritë e Ekzekutivit të Komunës për punën e tyre. Asnjë vit të hyrat vetanake nuk janë shpenzuar në tërësi ku vetëm për vitin 2014 janë alokuar 188,000.00 € nga viti paraprak në mënyrë jo të rregullt dhe ato mjete nuk janë destinuar aty ku ka qenë e paraparë. Gjithashtu lista e debitorëve ndaj Komunës e ka kaluar shifrën prej 8.7 milion eurove që e përbën afër gjysmën e buxhetit të Komunës tonë, gjë e cila është shumë shqetësuese si për ne po ashtu duhet të jetë edhe për Kryetarin e Komunës dhe Ekzekutivin e Komunës në tërësi, do të thotë kjo shifër është tejkaluar dhe nuk janë kryer pagesa. Lidhur me dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, Auditori i Përgjithshëm ka marrë vetëm gjashtë mostra, dhe ka gjetur se asnjë nga ata debitorë nuk kanë paguar asgjë për Komunën e Podujevës, por ne jemi të bindur se po t'i kishte hulumtuar edhe mostra tjera sigurisht se të gjitha do të dilnin ashtu, do të thotë pronat e Komunës shfrytëzohen por nuk paguhet qiraja, që kapë vlerën 8,548.00 € shumë e cila është dashur të paguhet nga shfrytëzuesit, dhe drejtorët e Drejtorive nuk janë në gjendje të bëjnë raportime për këtë çështje, disa nga ato prona tani janë në procedurën e ankandit publikë për dhënie me qira ku me Komisionin e juaj do të jepen në mënyrë jo të rregullt, çështje për të cilën do të debatojmë sot në pikën të ndryshme.

Mosrespektimi i kriterit për dosjen e tenderit, sipas dy mostrave që i ka marrë Auditori i Përgjithshëm, të dyja kanë rezultuar me shkelje ligjore nga një zyrtar i Prokurimit i cili është me shkollim të mesëm por sigurisht i certifikuar për prokurim, gjë e cila ka qenë edhe çështje mediale muajin e kaluar dhe për të cilën mendoj se është banale që në vitin 2014 një zyrtar pa përgatitje profesionale të menaxhojë buxhetin e Komunës prej afër 16 milion euro në vit apo 6 – 7 milion euro të Komunës në vit. Lidhur me kontratën për asfaltimin e rrugëve në fshatrat Tërnavë – Halabak në vlerë 130,825.00 € në dosjen e tenderit ka qenë kriter që operatori ekonomik të ketë listën e punëtorëve të nënshkruar dhe të vulosur në Administratën Tatimore të Kosovës për vitin 2013, gjë e cila ka munguar, gjithashtu te kontrata për asfaltimin e rrugëve në qytet, në vlerë 866,068.00 €, kriter në dosjen e tenderit ka qenë që operatori ekonomik të ketë vërtetim të tatimit në pronë gjë e cila është sjellë nga kompania përkatëse në emër të një kompanie tjetër, që do të thotë se nuk është plotësuar dosja e tenderit gjë për të cilën jemi në dijeni se mos plotësimi i dosjes së tenderit automatikisht operatori përkatës eliminohet nga gara ngase ia humb shansin një kompanie serioze për të marrë punë, ndërsa e njëjta kompani kishte bërë edhe nënkontratë për furnizim të asfaltit në masë 71% gjë e cila është shkelje ligjore që me siguri edhe zyrtari i Prokurimit është në dijeni për këtë, ngase Ligji i Prokurimit e lejon vetëm deri në masën 40% për punët e nënkontraktuara. Sa i përket regjistrimit të pasurive të Komunës, në bazë të gjetjeve të Auditorit të Përgjithshëm asnjë aset i Komunës deri në vlerën 1000,00 € nuk është i regjistruar nga Komisioni i cili ka raportuar më 20 janar 2014, ndërsa ne e kemi parasysh se sa pasuria në vlerë deri në 1000.00 € mundet me qenë pasuri e Komunës dhe e cila nuk është regjistruar në regjistrat digjital të Komunës në mënyrë që të jemi në dijeni se çka ka pasuri deri në atë vlerë Komuna jonë.

Te trajtimi i borxheve, ne jemi në dijeni se në vitin 2012 Komuna e Podujevës ka pasur borxhe apo obligime të papaguara një shumë prej 280,260.00 €, ndërsa në vitin 2013 ajo shumë është rritur 31%, andaj për këto dhe shumë gjetje të tjera nuk jam në dijeni se si mundet Grupi i këshilltarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Ekzekutivi i Komunës ta arsyeton punën e mirë dhe të rregullt të Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013, ne jetojmë në një kohë ku vetëm për disa pika të cilat i ceka janë shkelje ligjore dhe

Komuna e Podujevës është renditur në dhjetëshen e parë të Komunave më të papërgjegjshme, më jo në rregull dhe me debitin më të madh, kështu që unë në mënyrë publike ju bëj thirrje edhe mediave edhe organeve të rendit që ta hetojnë këtë auditim të Auditorit të Përgjithshëm dhe t'i hetojnë të gjitha këto shkelje ligjore në mënyrë që dikush të merret me çështjen e parasë publike, gjë e cila është në interes të të gjithëve sepse këto shkelje janë bërë me vetëdije, ne një ditë më parë në mbledhjen e KPF-së e patëm një arsyetim të drejtorit të Drejtorisë Buxhetit dhe Financave se dy kompanitë e përfolura nuk e kanë dëmtuar Komunën, ndërsa ne nuk jemi në dijeni se a është dëmtuar apo jo Komuna ngase janë humbur ofertat e ofertuesve tjerë ngase janë pranuar dy oferta tjera për punë në vlerë afër 1 milion euro të kompanive të papërgjegjshme të cilat vetëm dokumentacionin nuk kanë mundur ta përgatitin ashtu siç duhet e mos të flasim për masën e investimeve apo të asfaltit apo të mjeteve të kualitetit të sasisë së punëve, kështu që edhe njëherë bëj thirrje në mënyrë publike edhe mediave edhe organeve gjyqësore dhe atyre hetuese që të hetohen këto dy kontrata dhe puna e cila është kryer nga këto dy kompani për arsye se Auditori i Përgjithshëm e thërret Kryetarin e Komunës për ato kompani të cilat nuk ka marr masa administrative, të merr, dhe që të mbliidhen të ardhurat komunale nga ato prona të cilat janë dhënë me qira, ndërsa ato prona prapë janë qitur në ankand të jepen në shfrytëzim me qira në mënyrë të papërgjegjshme.

z. Haki Rudari, theksoi, ne si Grup së bashku me kryesinë e Lëvizjes Vetëvendosje kemi analizuar Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013. Është e ditur se këto auditime bëhen për të parë rregullsinë, performancën dhe transparencën financiare, duke e ditur se misioni i tij është për një menaxhim të shëndoshë financiarë në Administratën Publike, për rritjen e llogaridhënies publike ku ne si Grup vazhdimisht e kemi kërkuar.

Në vazhdim do t'i paraqes disa nga çështjet e cekura në këtë Raport të cilat secili nga ju mund ti vlerësoj si të dojë vet;

1-Në faqen 4 të raportit thuhet, regjistri i pasurive fikse ende nuk është i plotë dhe i saktë për arsye se janë identifikuar rrugë dhe kanalizime në vlerë 416,407.00 €, që nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk janë prezantuar në pasqyrat vjetore financiare.

2-Komuna ka bërë klasifikim të gabuar të shpenzimeve ku nga kategoria e investimeve kapitale ka paguar për mallra dhe shërbime në vlerë prej 88,104.00 €.

3-Rekomandimet e vitit 2012 nuk ishin arritur të adresohen në mënyrë të plotë gjë e cila rezulton me kontroll të dobëta apo humbje e potencialeve financiare të vazhdueshme.

4-Auditimi i Brendshëm plotëson vetëm pjesërisht planin e punës për vitet 2011 - 2012.

5-Ekzistojnë dobësi e sidomos në Prokurim ku janë nënshkruar kontrata me operatorë ekonomik të papërgjegjshëm, ka pasur klasifikime të gabuara të shpenzimeve në kode ekonomike.

6-Menaxhim i dobët i pronave komunale të dhëna me qira.

7-Komuna nuk ka arritur të krijoj një regjistër përfundimtarë të pasurive që i ka në posedim, edhe pas 15 viteve të çlirimit.

8-Janë disa rekomandime për Kryetarin, që sigurisht në të ardhmen do të përsëriten, e që kanë të bëjnë në radhë të parë me procesin e Prokurimit pastaj bashkëpunimin më të ngushtë me auditorin e brendshëm, klasifikimin më adekuat të shpenzimeve nëpër kode ekonomike.

9-Komuna nuk ka bërë planifikim të të hyrave sipas kategorive specifike.

10-Mos respektimi i kriterëve të vendosura në dosjet e tenderit ku thuhet se kërkesat administrative të prokurimit nuk janë zbatuar fare, gjë për të cilën mendoj se është shumë serioze dhe shqetësuese.

Duke u nisur nga të gjitha këto, besoj se Ekzekutivi i Komunës tonë do t'i merr për bazë dhe do t'i bëjë ndryshimet pozitive në mënyrë që ne në të ardhmen sigurisht se do të jemi më të gëzueshëm kur kemi të bëjmë me diçka pozitive.

z. Hasan Softolli, theksoi, Raporti i Auditimit paraqet një pasqyrë mbi menaxhimin e parasë publike, funksionimin e brendshëm dhe performancën e Komunës brenda një viti kalendarik i shoqëruar me të gjetura, rreziqe dhe në fund me rekomandime. Në përgjithësi ky Raport i Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013 është i kënaqshëm ngase në këtë auditim, vërejtjet dhe rekomandimet e dhëna janë të natyrës teknike si dhe disa janë të natyrës së politikës operative, mirëpo ky Raport nuk është i shoqëruar me parregullsi të natyrës së keqpërdorimit që do të bënte Komunën tonë të jetë në faqet mediale, por janë vërejtje dhe sugjerime të cilat më tepër fokusohen rreth menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm. Gjithashtu ky Raport nxjerr në pah Komunën tonë me një efikasitet të madh të shpenzimit të buxhetit me 90% të shpenzimeve të të hyrave, gjë e cila jep të kuptohet se Komuna ka performancë të lartë në zbatimin e politikës së projekteve dhe programeve në mënyrë që mjetet e grumbulluara të shfrytëzohen tërësisht.

Është e pamundur që gjatë punës njëvjeçare të mos lëshohet ndonjë gabim apo ndonjë vërejtje e paqëllimtë, e them këtë ngase të gjithë jemi në dijeni se për shkak të punëve dhe angazhimeve të shumta, punët operative është e pamundur të kryhen pa lëshuar ndonjë gabim, andaj edhe vërejtjet dhe sugjerimet të cilat i ka dhënë Auditori i Përgjithshëm janë të natyrës teknike për arsye se, nëse merren vërejtjet të cilat i kanë dhënë në lidhje me ndrrimin e mjeteve të kategoritë ekonomike do të shohim se asgjë nuk reflekton në shpenzimin e buxhetit, pra është një rekomandim i cili kurrfarë implikimi nuk ka në buxhet ngase mjetet të cilat kanë pasur të shpenzohen në një kategori të caktuar janë shpenzuar në një kategori tjetër të ngjashme dhe që është problem të caktohen se në cilat kategori bëjnë pjesë. Po ashtu vërejtjet që janë dhënë nga Auditori i Përgjithshëm lidhur me llogaritë e arkëtuara dhe llogaritë e pagueshme, konsideroj se secili institucion i ka ato vërejtje kur bëhet fjalë për llogaritë e pagueshme gjegjësisht borxhet, të cilat i përmendi edhe z. Rafet Llapashtica e të cilat janë mbi 8.7 milion euro, e them këtë ngase jemi në dijeni se far niveli të zhvillimit të ekonomisë kemi që do të thotë se është e pamundur të operohet pa borxhe apo të zvogëlohen ato borxhe, por kjo çështje për Komunën është e mirë ngase në qoftë se Komuna dëshiron ta forcoi aparatën e vet institucionale mund t'i arkëtoj ato borxhe, ndërsa llogaritë e pagueshme të cilat janë mbi 400,000.00 €, nuk është shumë shqetësuese krahasuar me borxhet ndaj Komunës që janë 8.7 milion euro. Sa i përket vërejtjeve të dhëna në lidhje me rrugën e fshatrave Tërnavë-Halabak, dëshiroj të shpjegoj se lista e pagave të punëtorëve të kompanive përkatëse që është kërkuar, që ka qenë një risi, kompanitë me vonesë e kanë kuptuar që Administrata Tatimore e Kosovës e lëshon këtë listë të pagave të punëtorëve.

Mund të them se në përgjithësi ky Raport nuk nxjerr diçka të keqe dhe nuk mund të thuhet se ka keqpërdorime, por vetëm gabime teknike të cilat ne i konsiderojmë si të natyrshme dhe të përmirësueshme dhe nuk mund të thuhet se këto të gjetura janë për faqe mediale siç kemi rastin në Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave e cila është përgjegjëse për menaxhimin e parasë publike, ku

në kontratën e saj për mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve zyrtare vetëm për servisim të një automjeti zyrtar ka shpenzuar 16,565.00 €.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, mora fjalën t'ja rikujtoj parafolësit se Ligji i Prokurimit sktësisht e thotë se, asnjë kompani publike nuk ka të drejtë të kontrakttoj apo nënkontrakttoj punë apo të jetë nënkontraktuese e një kompanie tjetër mbi masën mbi 40%, ndërsa kompanisë të cilës i ka dhënë punë Ekzekutivi i Komunës, ka kontraktuar punë në masën 71% për shtrimin e asfaltit, gjë e cila është shkelje ligjore. Prandaj unë debatova për shkelje ligjore dhe bëra thirrje për hetim të kësaj çështjeje me emër e me mbiemër dhe me numër të kontratës, dhe ne këtu jemi duke folur për të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm, nuk jemi duke debatuar mes këshilltarëve apo mes subjekteve politike që do të thotë jemi duke debatuar për punë konkrete ku kompania përkatëse ka nënkontraktuar një kompani tjetër të shtroi asfalt në masën 71%. Ndërsa besoj se nuk ka kompani e as nuk ka shef të prokurimit që së paku që 7-8 vite që nuk është në dëgjim se punëtorët e kompanive duhet të jenë të regjistruar në Administratën Tatimore të Kosovës dhe që duhet të paguaj çdo kompani tatim për pagat e punëtorëve, ndërsa kompania në fjalë e ka sjellë listën e pagave të punëtorëve të kompanisë tjetër kurse kompania e cila ka marrë tenderin në emrin e tij nuk e ka as edhe një lopatë dhe fiton tender ndërsa punën e shet, e kjo është shkelje ligjore.

Nëse për parafolësin si këshilltarë i Kuvendit të Komunës nuk është shqetësuese shuma 8.7 milion euro debit për Komunën tonë e cila ka 8 milion euro për investime kapitale për një vit, atëherë nuk e di se si parafolësi i mbron interesat e votuesve të tij dhe të qytetarëve në përgjithësi, pra konsideroj se kjo është shumë shqetësuese, dhe nuk dua ta mohoj kapacitetin e vlerësimit tënd i nderuar këshilltarë (i drejtohet z. Hasan Softollit), por mendoj se duhet të jetë shqetësuese dhe automatikisht udhëzohet Kryetari i Komunës që të merr masa administrative ndaj përgjegjësve.

Andaj bëra thirrje që këto gjetje në mënyrë specifike të publikohen nga mediat dhe të hetohen nga organet e hetuesisë bashkë me gjashtë mostrat e pronave të Komunës të dhëna me qira dhe që nuk është paguar qiraja sepse kemi prona që Komuna i ka dhënë që 14 vite me qira dhe që nuk është paguar asnjëherë qiraja.

z. Flakron Gashi, theksoi, sa i përket Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013 edhe ne do të ishim të kënaqur në qoftë se ky raport do të ishte mirë sepse ne jemi këtu për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e qytetarëve e jo për të shërbyer maskilizëm për një keqqeverisje.

Dua të specifikoj tri çështje, ku në faqen katërt të raportit thuhet, auditimi është fokusuar në tri çështje konkrete,

-Pajtuëshmërinë me kornizën e raportimit dhe rreziqet domethënëse për pasqyrat vjetore financiare të theksuara në memon e planifikimit të auditimit.

Kjo lehtë të nënkuptohet që ka pasur përputhshmëri të legjislacionit apo rregullave në fuqi, mirëpo në brendësi thuhet se shpesh herë nuk respektohen këto rregulla.

-Reagimi ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe disa këshilltarë parafolës e than se jemi të kënaqur dhe e vlerësojmë këtë raport të Auditorit të Përgjithshëm, ndërsa unë pyes se si mund të jeni të kënaqur dhe si mund ta vlerësoni pozitivisht Raportin ku prej 15 rekomandimeve të dhëna nga Auditori i Përgjithshëm për vitin 2012, vetëm 5 nga ato janë

adresuar, 5 nga ato nuk janë në proces apo nuk janë adresuar fare dhe 5 nga ato rekomandime nuk janë adresuar fare hiq, dhe çështja e tretë,

-Menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm të Komunës (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit dhe auditimin e brendshëm).

Pra këto janë tri fusha kryesore ku me të parën po pajtohemi deri diku ndërsa e dyta nuk është askund fare, dhe e treta kryesisht fokusin e ka te Prokurimi, te të hyrat, dhe menaxhimi i pasurisë, sa i përket Prokurimit nuk dua të flas më shumë dhe të jap detaje ngase të gjitha u than nga kolegët parafolës, mirëpo në këtë mbledhje kemi në rend dite edhe Raportin financiar dhe aty do të dalin të metat ku shihet se prej 61 projekteve të cilat janë ndërmarrë vetëm dy kompani e kanë rreth 30% të vlerës së kostos totale materiale të cilat bëjnë rreth 300,000.00 €, ku kjo çështje të shtyn te ajo që gjatë procesit të Prokurimit ka pas shkelje të rregullave ku u janë dhënë punët operatorëve të papërgjegjshëm. Sa i përket çështjes së raportimit te menaxhmenti i lartë, në raport thuhet se shpesh herë drejtorët e Drejtorive nuk bëjnë forma të rregullta të raportimit për punën e tyre, dhe për të vërtetuar këtë do të marr një shembull, ku në një nga seancat e kaluara të Kuvendit një drejtor nuk ishte në dijeni se a i ka ardhur një shkresë apo jo ndërsa Kryetari i Komunës ishte në dijeni se ajo shkresë ka ardhur, pra kjo tregon për menaxhim të dobët dhe kompletimin e strukturës së brendshme dhe vijës vertikale të tyre. Çështja tjetër ka të bëjë me të hyrat, ne të gjithë jemi në dijeni se borxhi është rritur, për këtë mendoj se me qasjen dhe me shkeljen e Rregulloreve nga disa nëpunës të Administratës Komunale, ai borxh do të rritet gjithë herë dhe besoj se edhe ju jeni në dijeni se disa shpeditet të disa kompanive të sigurimit me nga një kafe nxjerrin vërtetime të tatimit në pronë për t'i regjistruar automjetet e klientëve të tyre. Gjithashtu çështja që ka të bëjë me menaxhimin e pasurisë së Komunës siç ishte rasti te qiraja, dhe gjëra të ngjashme, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave e tha se tatimpaguesit janë të kënaqur, e për këtë unë pyes se cila është baza e arsyes që tatimpaguesit janë të kënaqur, në bazë të cilës anketë apo cilit hulumtim ka ardhur deri te kjo.

z. Naim Çunaku, theksoi, u tha shumë për Raportin e Auditorit të Përgjithshëm, për mua nuk janë diçka e madhe të gjeturat nga auditimi, e them këtë duke u mbështetur në atë se punohet pa pasur plan të prokurimit çështje ku është vu në akcent dhe ku menaxhohet paraja publike me tenderime, je në dijeni se disa herë e kemi potencuar edhe në KPF edhe në Kuvend se Zyra e Prokurimit e ka obligim ligjor që çdo fillim vit ta paraqet planin e punës në Komitetin për Politikë dhe Financa, gjë të cilën ajo zyrë nuk e ka bë, që do të thotë se qysh në start ka filluar për të keq qeverisë duke mos përfillur aktet normative që e rregullojnë formën e veprimit. U tha nga disa parafolës se Komuna e Podujevës ka pasur një shpenzim të mirë të buxhetit të vet, mirëpo në Raportin e Auditimit unë vërejtja një konstatim të Auditorit që askush deri më tani nuk foli për atë, ku Komuna e Podujevës ka hyrë në mesin e dhjetë Komunave që ka hyrë në borxhe dhe që kanë obligime më së shumti në nivel të Kosovës, do të thotë se buxheti është shfrytëzuar por edhe është tejkaluar. Gjithashtu në këtë Raport vërejtja diçka që unë nuk mund të pajtohem me atë që e ka bërë këtë Raport, e që thuhet se Ekzekutivi i Komunës ka raportuar në Kuvendin e Komunës, ashtu siç obligohet me ligjin mbi menaxhimin e financave publike ta paraqesë gjendjen ekonomiko-financiare të Komunës çdo tre muaj, pra në Raport të Auditorit të Përgjithshëm konstatohet se Ekzekutivi i Komunës këtë e ka bërë, ndërsa unë pyes se a kemi pasur raport nëntë mujorë dhe dymbëdhjetë mujorë për vitin 2013 nga Ekzekutivi i Komunës dhe raport tremujorë për vitin 2014, sigurish që jo, atëherë nuk di

se ku e ka marr atë ekzemplarë apo dokument që të mund të konstatoj Auditori i Përgjithshëm diçka që nuk ka ndodh, dhe për këtë mendoj se mund të bëhet fjalë për ndonjë keqkuptim apo për ndonjë falsifikim ngase tjetër gjë nuk mund të ketë.

Përshtypje tjetër më bëri çështja që ka të bëjë me defektet të cilat janë evidentuar në Raport si theksime të çështjeve, ku nga një parafolës u tha se lidhur me listën e pagave të punëtorëve të kompanive Komuna nuk e ka ditur këtë ndërsa unë mendoj se Kompanitë këtë e kanë ditur, mirëpo një gjë e cila është abc e që duhet ta dinë të gjithë, është se nëse nuk i përmbush kriteret formale juridike të përcaktuara çdo gjë shpallet zero dhe eliminohet, e them këtë ngase lista e pagave të punëtorëve të kompanive ka qenë kriter i aplikimit dhe nëse ajo kompani e cila se ka përmbushur këtë kriter, sigurisht se kemi të bëjmë me parregullsi, ndërsa se ajo parregullsi a ka shkaktuar dëme financiare apo dëme financiare është temë tjetër, mirëpo kryesorja është se ajo kompani nuk ka mundur të jetë përfituese e atij tenderi nëse nuk i ka përmbushur kushtet formale juridike të përcaktuara nga hartuesi i tenderit, prandaj edhe është cekur në këtë Raport, ngase nuk është dashur të ndodh ajo që ka ndodh. Çështje tjetër që vërejtja dhe që u përmend edhe një parafolës është edhe inkasimi i të hyrave vetanake, sigurisht se të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës janë në dijeni se të hyrat nga tatimi në pronë është shumë e lehtë të inkasohen ngase Komuna i ka aktet e miratuara të cilat e rregullojnë këtë çështje ku përqindja më e madhe e inkasimit të të hyrave është nga tatimi në pronë, por vlen të përmendet edhe taksa komunale e cila nga shumica e komunave të Kosovës është hequr fare, me qëllim të lehtësimit të ushtrimit të veprimtarive biznesore, mirëpo për mua është e pakuptueshme se si Komuna e Podujevës nuk mund të inkasoj e qiranë e pronës së vet, e them këtë ngase si mundet që me vite të tëra jepet prona e komunale me qira ku dikush e shfrytëzon dhe përfiton nga ajo pronë dhe nuk i paqan obligimet e qirasë të pronës komunale, unë jam në dijeni se kush janë ata persona (i përgjigjet z. Avni Ajetit i cili pyet nga vendi), dhe për të treguar se kush janë ata persona është Ekzekutivi i Komunës që duhet të bënë atë, dhe në këtë kontekst është një prej sugjerimeve të mia që në një të ardhme të afërt Ekzekutivi i Komunës të harton listën e pronave komunale të cilat i ka në shfrytëzim, emrat e atyre që i shfrytëzojnë ato prona dhe obligimet që i kanë ata shfrytëzues.

z. Haki Rudari, theksoi, për të gjeturat nga Auditori i Përgjithshëm besoj se materiali është i njëjtë për të gjithë andaj do t'i ceku disa çështje për të cilat u dhanë mendime të ndryshme. Në faqen 17 çështja e pestë në Raport thuhet, e gjetura, Komuna nga gjithsejtë shuma e kontraktuar prej 112,127.00 € për pronat e dhëna me qira gjatë vitit 2013 kishte inkasuar vetëm 38,561.00 € apo 1/3-ta e qirave gjë për të cilën mendoj se është shumë shqetësuese, gjithashtu në Raport thuhet, ne kemi testuar gjashtë mostra të dhënies me qira të pronës komunale në vlerë prej 8,548.00 € dhe kemi vërejtur se këta shfrytëzues nuk kishin paguar fare obligimet e tyre, po ashtu është shqetësuese, pastaj thuhet, Komuna nuk kishte ndërmarr asnjë masë për të obliguar shfrytëzuesit që t'i kryejnë obligimet e tyre ku borxhi total i tyre arrin vlerën 53,629.00 €, mandej në Raport thuhet, shuma totale e debitorëve të Komunës për qiratë e pa paguara deri në fund të vitit 2013 arrin vlerën 590,272.00 €, gjë e cila gjithashtu është shqetësuese, pra nuk i themi ne këto gjëra se kemi qejf ngase edhe ne jemi pjesë e Komunës, jemi banorë dhe taksapagues të Komunës, si dhe nuk i gëzohemi asaj që Komuna jonë është në mesin e dhjetë komunave me borxhe më të mëdha, por i themi me qëllim që në të ardhmen të ndryshoj pozitivisht kjo. Pastaj te e njëjta çështje në Raport thuhet, rreziku, ku borxhet e

grumbulluara të pa inkasuara janë ekuivalente me gjysmën e buxhetit vjetorë të Komunës për vitin 2013, dhe menjëherë e kemi rekomandimin pesë ku thuhet, Kryetari i Komunës duhet të zbatoj rishikimin sistematik për të arritur shkallën e inkasimit të të hyrave.

Në faqen 19 të Raportit të çështja gjashtë thuhet, rreziku, kërkesat administrative të Prokurimit nuk janë zbatuar, dështimi i ndjekjes së procedurave të prokurimit dhe udhëzimeve shoqëruese mund të rezultojë me përzgjedhjen e ofertuesve të pa përgjegjshëm, gjë për të cilën drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në mbledhjen e KPF-së më bëri përshtypje që për këtë çështje e mori krejt bardh por unë mendoj se nuk është bash ashtu si ai mendon dhe është mirë që për çështje të cilat janë bardh të thuhën ashtu por kur janë zi të pranohen.

Pra ka edhe shumë gjëra të tjera për të cilat duhet të debatojmë por nuk dua të zgjas më shumë por mendoj se është mirë që të gjithë të mundohemi të japim kontributin tonë.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, unë do të mundohem t'i jap vetëm disa sqarime për çështje të cilat u ngritën, unë edhe një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kam dhënë një konstatim se jam i kënaqur me opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013 ngase nuk kam arsye që të mos jem i kënaqur për shkak se është një rezultat i punës një vjeçare të Komunës, dhe në lidhje me këtë do të marr një shembull, gjatë një viti mësimorë nxënësve iu komunikohet rezultati dhe iu tregohet secilit se si ka kaluar, opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Komunën e Podujevës është shumë i mirë dhe i ka dhjetë rekomandime përmes të cilave sugjerohemi që të përmirësohemi në çështje konkrete, pra lidhur me shembullin e mëparshëm, është njëjtë sikurse kur t'i thuash nxënësit se ke kaluar shkëlqyeshëm por i ka dy nota 4 dhe një 3 dhe me këtë jam i kënaqur me ty por duke i pasur parasysh këto tri fusha për të cilat të sugjeroj të përmirësohesh vitin e ardhshëm. Prandaj edhe unë e thash se jam i kënaqur me opinionin e Auditorit ngase është opinion maksimal por sigurisht se edhe unë do të doja që ky Raport të mos i kishte ato të gjetura. Unë edhe në dokumentin e dërguar kam qenë shumë modest dhe i kam përmendur tri pikat kryesore të cilat i përmendi edhe z. Flakron Gashi, dobësitë në fushën e Prokurimit, mosrealizimin e të hyrave për të cilën shumë do të doja të ishte më mirë se që është si dhe pikën tre që ka të bëjë me menaxhimin e pasurive, do të thotë unë nuk kam dashur ta zbukuroj por i kam cekur këto të gjitha dhe jam munduar që me një faqe t'i përfshijë tridhjetë faqe të raportit të paraqitur nga Auditori i Përgjithshëm i cili është një organ i pavarur, dhe do të sqaroj disa pika të cilat u ceken apo që disa parafolës shpreh shqetësim për to.

Lidhur me rekomandimet nga viti i kaluar ku shihet se në vitin 2012 kanë qenë 15 rekomandime ndërsa në vitin 2013 kemi pasur 10 rekomandime, do të thotë kemi zvogëlim për 5, ngase jemi marr dhe jemi duke u marr me një plan të veprimit ku në vitin 2014 presim që të zvogëlohet shumë ky numër apo mos të kemi rekomandime fare.

Sa i përket pagesave në kode të ndryshme ekonomike do të jap një sqarim të cilin jua kam bërë edhe auditorëve, në buxhetin e vitit 2013 por edhe në vitin 2014 e kemi projektin, mirëmbajtja dhe ruajtja e shesheve, parqeve dhe ambienteve, projekt i cili është në kapitale dhe për këtë shkak kemi vërejtje nga auditori ngase ai thotë se ka mundur që të bëhen nga kategoria mallra dhe shërbime, gjë e cila mund të jetë logjike por nuk e kemi ndërruar në destinimin por ashtu ka qenë e paraparë, ndërsa vërejtja tjetër ka të bëjë me blerjen e lloptopëve për këshilltarët e Kuvendit të Komunës, ku edhe ato mjete janë marr nga ai kod ekonomik, dhe atëherë kur është bërë kërkesa për lloptop unë ju

kam thënë se është vështirë të realizohet nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve dhe për këtë shkak e kemi futur si projekt kapital, pra secili nga ne këtë mund të analizojmë, nëse shikohen 21,000.00 € që janë blerë llaptopët mund t'i fusim në kategorinë e kapitaleve, por nëse shikohet vetëm një llaptop që kushton rreth 300 – 400 € mund të fusim në kategorinë mallra dhe shërbime, si dhe kemi tjetrën çështje e cila hynë në shumën 80,000.00 € ku thuhet, mbyllja e deponime të egra e cila është në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të miratuar me projektbuxhet në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe në Kuvendin e Kosovës si projekt kapital ku ne edhe kemi bërë shpenzimin, për këtë çështje ne jemi dakorduar teoritikisht edhe me Auditorët, por ata janë profesionist dhe duhet të shkruajnë, pavarësisht se janë pajtuar me kundërshtimin tim, prandaj të jeni në dijeni të gjithë se ne nuk e kemi bërë ndryshimin e kodit sipas tekeve tona, por e kemi zbatuar ligjin dhe buxhetin e Komunës ashtu siç është i miratuar në Kuvendin e Komunës, Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Pastaj në Raport thuhet, mos shpenzimi i të hyrave vetanake, unë e kam cekur në KPF dhe e kam diskutuar me zyrtarët e Auditorit të Përgjithshëm se me këto procedura ligjore të cilat janë në fuqi, është e pamundur të shpenzohen të gjitha të hyrat që bëhen brenda një viti fiskal, e them këtë ngase për investimet kapitale, zotimet e mjeteve buxhetore përfundojnë nga 5 deri 7 shtator të çdo viti dhe më nuk mund të bëhen zotime për investime kapitale, ndërsa inkasimi i mjeteve nga Komunitet bëhet edhe pas këtyre datave përkatësisht deri më 31 dhjetor ora 24,00 për çdo vit, të hyra të cilat i takojnë atij viti përkatës, prandaj duhet të barten në vitin tjetër ngase nuk mund të realizohen, kështu që përderisa të ndërmerret ndonjë ndërhyrje në ligjin përkatës të ndryshohet apo plotësohet, gjithë herë do të ketë vend për vërejtje si nga këshilltarët e Kuvendit, nga Auditori i Përgjithshëm, po ashtu edhe nga Ministria e Financave, mirëpo kështu do të jetë çdo herë sepse nuk mund të jetë ndryshe, e nëse gjeni ndonjë rast tjetër ndokush nga ju lirshëm mund të më thoni dhe unë do të shpenzoj ato mjete.

Në mos realizimin e të hyrave vetanake janë tri kategori kryesore të cilat na shqetësojnë, e përshëndes atë që një kategori e të hyrave nga tatimi në pronë vazhdimisht vie duke u rritur mirëpo borxhi kryesor i Komunës i takon kësaj kategorie për shkak se janë 20,000 prona të tatuara dhe për këto prona ka edhe ndëshkime, pra ky borxh i qytetarëve kalkulohet dhe çdo gjashtë muaj rritet, pra borxhet janë duke u ndëshkuar dhe për këtë çështje unë personalisht me instanca më të larta kam kërkuar që ndëshkimet e borxheve të tatimit në pronë të hiqen për ata njerëz të cilët kanë shtëpia vetëm për ekzistencë dhe nuk kam hasur në mirëkuptim, dhe vazhdohet të ketë ndëshkime për të gjitha shtresat dhe kategoritë e familjeve që kanë borxhe nga tatimi në pronë, pra nëse i kemi 5 milion euro borxh në vit ai borxh rritet 900,000.00 € në muaj dhe plus 10% dënim, pra lirshëm mund të them se vitin e ardhshëm mund të ketë një shumë prej 6 milion euro borxhe të tatimit në pronë.

Sa i përket regjistrimit të inventarizimit, e thamë se nuk është i plotë në mënyrë digjitale apo në mënyrë elektronike, por në mënyrë të shkruar është i evidentuar për secilin inventarë të secilës zyre, gjë të cilën secili nga ju kur të dëshironi mund ta shihni.

Lidhur me borxhet e Komunës unë e kam cekur edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa se ne e kemi raportuar borxhin që është mbi 300,000.00 € në Raportin Financiar për vitin 2013 dhe Auditori i Përgjithshëm këtë shumë të mjeteve e ka marrë nga Raporti Financiar të cilin e kemi paraqitur ne në Kuvendin e Komunës, dhe atë shumë e ka cekë në raportin e tyre të auditimit, dhe për këtë çështje pa asnjë hezitim po e them se në qoftë

se të gjitha Komunat e Kosovës janë me borxhe deri në 300.000,00 €, Komuna e Podujevës qëndron shumë mirë dhe do t'i zvogëloj sa më parë ato borxhe, por lidhur me këtë po i përmendi vetëm tri shembuj, në takimin e Asociacionit të Komunave me drejtorë të Drejtorive të Buxhetit dhe Financave, drejtori përkatës i Komunës së Kaçanikut ka thënë se i ka borxhe vetëm 9,000.00 €, drejtori nga Komuna e Vushtrrisë ka thënë se i ka borxhe vetëm 70,000.00 €, unë nuk kam dhënë shifër fare, kurse të gjithë drejtorët e Komunave tjera kanë thënë se kanë borxhe mbi 1 milion euro e deri në 9 milion euro Komuna e Gjakovës dhe 6 milion euro Komuna e Gjilanit, e nëse ato Komuna nuk i kanë paraqitur ato borxhe le të jetë problem i tyre por nëse Komuna e Podujevës, ajo e Kaçanikut dhe Komuna e Vushtrrisë janë në mesin e dhjetë Komunave me borxhin më të madh me këto shifra që ne i kemi deklaruar, prapë po e them se jam i kënaqur.

Në Raportin e Auditorit të Përgjithshëm thuhet se, në regjistrimin e pasurive kapitale, Komuna e Podujevës nuk i ka regjistruar të gjitha pasuritë, gjë e cila ka ngjashmëri me të hyrat vetanake, ne bëjmë pagesa deri me 31 dhjetorë të çdo viti deri në orën 16;00 apo nganjëherë 18;00, dhe ato pagesa nuk kanë mundur të regjistrohen automatikisht si pasuri, pra fjala është për rrugë, kanalizime, ujësjellës, e të ngjashme, pasuri të cilat nuk mund të keq përdoren, por do të regjistrohen këtë vit dhe paraqiten në pasqyrat financiare për vitin 2014, do të thotë ato pasuri nuk kanë humbur por do të regjistrohen.

Gjithashtu në Raport thuhet, planifikimi i të hyrave sipas llojeve specifike, këtë çështje jam munduar t'ia sqaroj auditorit se planifikimin e të hyrave e bëjmë sipas një formulari unik që e ka lëshuar Ministria e Financave – Departamenti i Buxheteve Komunale, dhe ne planifikimin e bëjmë në bazë atyre vijave, megjithatë auditorët kanë thënë se duhet të jetë ndryshe.

Në Raportin e Auditorit thuhet se Komuna e Podujevës ka raportuar sipas suazave të Ligjit, unë jua rikujtoj se i kemi paraqitur, raportin tre mujorë, raportin gjashtë mujorë, raportin nëntë mujorë se kemi paraqitur ngase ka qenë fushat zgjedhore, dhe e kemi paraqitur raportin final vjetorë për vitin 2013, pra kjo është realitet.

z. Naim Çunaku, theksoi, me sinjeritetin më të madhe po i drejtohem drejtorit parafolës dhe e them se jam një kohë të gjatë pjesë e këtij Kuvendi dhe çdo herë e kam përgëzuar dhe e kemi mbështet çdo hap që Ekzekutivi i Komunës e ka bërë ku duhet dhe si duhet. Është e vërtetë që vitin e fundit të mandatit të kaluar, gjegjësisht viti 2013, ka filluar për herë të parë të silltet në Kuvend raporti financiar tre mujorë dhe ai gjashtë mujorë, gjë të cilën e kam mbështetur dhe ju kam përgëzuar për këtë, ndërsa kurrfarë arsyeje nuk ka qenë që ka qenë fushat zgjedhore që se kemi pasur raportin nëntë mujorë, edhe një herë po e them se çdo veprim që bëhet duke u mbështet në ligje dhe akte tjera do ta ketë mbështetjen time, andaj unë në diskutimin tim të mëparshëm vetëm i përmenda dispozitat ligjore të cilat përcaktojnë se raportet periodike – çdo tre muaj janë obligim i Ekzekutivit të Komunës t'i sjell në Kuvend, pra ne në vitin e kaluar nuk e kemi pasur raportin e parë tre mujorë dhe po ashtu nuk e kemi as në këtë vit, pra është një formë që përcaktohet me ligj dhe thjesht ne kemi dashur t'i kemi ato raporte.

z. Flakron Gashi, theksoi, lidhur me kohën e zgjatjes së diskutimeve për këshilltarët e Kuvendit dhe drejtorëve të Drejtorive nga ana e Kryesuesit të Kuvendit shpresoj që mos të del kjo në procesverbal si diskriminim pozitiv në favor të subjektit politik të cilit i takon Kryesuesi ngase dikush mban fjalën 20 minuta e dikujt nuk i lejohet më shumë se 1 minutë. Mora fjalën të replikoj me drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave lidhur me analogjinë që ai e mori si shembullin nxënësin, por në këtë kontekst e pyes drejtorin

se me cilën rregullore të arsimit kushtëzohet që nxënësi t'i ketë të gjitha notat 5, pra konsideroj se nuk është krahasim i arsyeshëm ai që bëri drejtori, ngase për faktin që nuk keni mundur t'i kryeni detyrat siç duhet nuk duhet të justifikoni. Gjithashtu drejtori e tha se është sukses që e kemi ulur numrin e rekomandimeve nga 15 në 10 rekomandime, por për këtë unë mendoj se ky është avaz i vjetër ngase rekomandimi për Prokurim është dy vite radhazi e sipas gjitha gjasave do të vazhdoj edhe vitin e ardhshëm. Gjithashtu drejtori iu shmangu dy pyetjeve, njëra ishte që unë pyeta se a keni njohuri, pse te tatimi në pronë ka shmangie nga disa qytetarë përmes ndërmjetësimit nga disa shpeditër të cilët i kryejnë sigurimet e automjeteve dhe zyrtarëve të cilët punojnë në atë zyrë, dhe pyetja tjetër ishte, në çka bazoheni kur thua që qytetarët janë të kënaqur kur dihet se Komuna e Podujevës i ka rreth 90000 banorë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, paraprakisht nga këshilltarët e Kuvendit kërkoj ndjesë, por është caktuar me protokoll zyrtar që unë në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit dhe shefat e Grupeve të këshilltarëve, me të cilët sapo u konsultova, të takohemi dhe të bëjmë disa vizita me delegacionin nga qyteti i Westerstedes të Gjermanisë, andaj propozoj që të kemi pauzë deri në ora 16:00,

Pas votimit u konstatua se me shumicë të votave u miratua propozimi i Kryesuesit që të ketë pauzë deri në ora 16:00

Pas pauzës prej katër orëve, mbledhja rifillon në orën 16:00, fillimisht u konstatua se ekziston kuorumi përkatësisht janë të pranishëm shumica e këshilltarëve të Kuvendit.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, përshëndetje për të gjithë, prapë kërkoj ndjesë për pauzën pak sa të gjatë që patëm, mirëpo pa humbur kohë mund të vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës aty ku mbetëm.

z. Kadri Avdiu, theksoi, lidhur me Raportin e Auditimit të Përgjithshëm u diskutua shumë dhe u dhanë shumë vërejtje, sugjerime dhe sqarime, mirëpo unë mora fjalën ngase më bëri përshtypje drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave i cili mori një shembull për të cilin unë mendoj se ishte një shaka nga ana e tij ngase një far forme po i bie sikurse Ekzekutivi i Komunës të jetë nxënës ndërsa auditorët profesorë, pra për mendimin tim ishte pak sa banale, ndërsa ndokujt iu duk interesante, ndërsa unë si përgjigje ndaj drejtorit e kam këtë, sipas Raportit përkatës, dhe shembullit të drejtorit, ne kemi të bëjmë me suksesin mjaftueshëm të nxënësit ndërsa në vitin tjetër nëse nuk përmirësohet nxënësi me siguri se do të ngelë.

Në bazë të gjeturave të Auditorit të Përgjithshëm, ne si Pozita ashtu edhe opozita duhet të jemi shumë real dhe ti gjejmë argumentet, ti shohim dhe ti themi ato, në mënyrë që qëllimi i dy palëve të jetë përmirësimi i gabimeve dhe i lëshimeve, pra nuk është qëllimi që të ta vejmë ndokënd në situatë të keqe. Ne edhe mandatin e kaluar, por edhe në këtë mandat, i kemi gjetur dobësitë dhe gabimet e bëra nga Ekzekutivi i Komunës dhe i kemi cekur në këtë Kuvend, gabime, lëshime dhe dobësi të cilat i ka vërtetuar edhe Auditori i Përgjithshëm në këtë Raport, ku disa nga ato që e kemi theksuar ka qenë se është investuar pa miratim të Kuvendit, destinimi i mjeteve nga një projekt në tjetrin gjëra të cilat kanë ndodhur në periudhat e fushatave zgjedhore, dhe kjo nuk mund të lihet pa u thënë për shkak se është gjë e vërtetë, unë këtë e kam cekur edhe para tri seancave këtë, pa e ditur se kjo çështje do të ceket edhe në Raportin e Auditorit, ku kam thënë se Komuna ka

bërë një pazar me kompani përkatëse ku kryhen punë pa pasur mbulesë buxhetore, pa miratim të Kuvendit, nuk jam kundër shtrimit të rrugëve por kemi dashur gjithherë që ato punë të legalizohen ku ka mundur me një rishikim të buxhetit ato mjete të barten në projekte përkatëse, e që tani nuk do të figuronte kjo vërejtje në Raportin e Auditorit të Përgjithshëm, ndërsa për Auditorin e Brendshëm nuk kemi çka të flasim ngase asnjëherë nuk kemi pasur Raport, raport i cili do ta ndihmonte Kryetarin e Komunës dhe Ekzekutivin e Komunës në përgjithësi, por edhe Kuvendin e Komunës. Prandaj rekomandime dhe të gjetura të Auditorit të Përgjithshëm janë të dobishme në mënyrë që t'iu bëhet me dije Kryetarit të Komunës, Ekzekutivit të Komunës, këshilltarëve të Kuvendit, se ne e kemi marrë besimin nga votuesit e Komunës tonë dhe jemi të obliguar se moralisht ashtu edhe politikisht që çfarëdo që të ndodh në territorin e kësaj Komune, ti analizojmë, ti parashohim dhe të mundohemi të gjejmë zgjidhje dhe ti parandalojmë ato.

Unë mendoj se në disa aspekte kur na është paraqitur ndonjë kërkesë e arsyeshme nga Ekzekutivi i Komunës, dhe që ka qenë në interes të qytetarëve, ne si opozitë e kemi mbështetur me gjithë vullnet, ngase nuk jemi ne këtu për të bërë politika, andaj besoj se nuk do të kishte aq shumë diskutime për këtë Raport të Auditorit të Përgjithshëm, po të pranohej në fillim se ekzistojnë këto lëshime dhe këto dobësi por i kemi edhe përparësi dhe të mira tjera, mirëpo të thuhet se është gjithçka në rregull dhe e pastër konsideroj se është e papranueshme.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, me sa po vërejë, diskutimet për Raportin e Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të Komunës së Podujevës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2013 u shteren, dhe meqë ky material nuk ka nevojë t'iu nënshtrohet procedurave të votimit, unë dëshiroj të jap vetëm një sqarim ku në bazë të auditimit nga Auditori i Përgjithshëm për Komunën e Podujevës është dhënë opinion i pamodifikuar por me theksim të çështjes, nuk them se nuk ekzistojnë lëshime mirëpo në Raport janë dhënë disa rekomandime me qëllim që në vitet tjera të përmirësohen.

Vlen të theksohet se nuk kam dëgjuar për asnjë institucion që nuk ka ndonjë vërejtje apo rekomandim nga Auditori i Përgjithshëm, mirëpo e rëndësishme është që ne në përgjithësi si Komunë kemi dalë mirë, pavarësisht se ndokush mund të interpretoj njëanshëm në mënyrë negative këtë raport, mirëpo gjithashtu e rëndësishme është që ky raport është publik dhe mund të shikohet edhe nga qytetarët por edhe nga mediat.

Debat i cili u bë në këtë mbledhje për këtë pikë me siguri se do të na shtynë që në të ardhmen ti përmirësojmë ato rekomandime në mënyrë që të jemi sa më të suksesshëm.

4. Raporti financiar për periudhën janar - qershor 2014

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, shprehi vlerësimin dhe opinionin tonë për raportin financiar për periudhën janar - qershor 2014, për të cilin mendojmë dhe vlerësojmë se e plotëson kërkesën ligjore ku Ligji e thotë, të jetë një raport përmbledhës i cili pasqyron të ardhurat dhe shpenzimet e periudhës përkatëse. Konsiderojmë se raporti në fjalë pasqyron në mënyrë mjaft të qartë të ardhurat dhe shpenzimet që kanë ndodhur në Komunën tonë gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu vlerësojmë se është një raport gjith

përfshirës, real, i thjeshtë dhe i kuptueshëm si për profesionistët ashtu edhe për jo profesionistët si dhe është raport i përgatitur shumë mirë si në aspektin profesional ashtu edhe në aspektin teknik, dhe për këtë e përgëzoj drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave dhe gjithë stafin e tij punues.

Në raportin financiar përkatës, fillimisht paraqiten shpenzimet e bëra për këtë periudhë e të cilat janë 7,031,977.00 €, duke shprehur këtë shumë sipas burimit dhe për çka këto mjete janë harxhuar dhe duke vazhduar me paraqitjen sipas llojit të shpenzimeve siç janë; paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe transfere dhe investime kapitale, të gjitha këto të shprehura edhe në përqindje dhe duke krahasuar njëkohësisht me periudhën e ngjashme të një viti më parë, andaj kjo na mundëson të shohim progresin që ka ndodhur.

Gjithashtu në këtë raport përveç shpenzimeve paraqiten edhe të hyrat e planifikuara dhe të realizuara gjatë periudhës janar – qershor 2014 ku edhe shihet një ngritje e lehtë e inkasimit të të hyrave në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Pra mendoj se ky raport meriton të vlerësohet dhe të përkrahet pa pretenduar se nuk ka vend edhe për më mirë.

z. Naim Çunaku, theksoi, po e përsëriti drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave në një segment, që një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, rrodhi një propozim që nga ajo që u pa nga raporti i Auditorit të Përgjithshëm, dhe që u pa se Komuna jonë din të tregoj edhe nikoqirllëk apo mikpritje të mirë dhe në vazhden e asaj mikpritjeje Komiteti për Politikë dhe Financa i propozoi Kryesuesit të Kuvendit që në agjendën për pritjen e delegacionit të qytetit Westerstede nga Gjermania të jetë në përbërje Kuvendi, por ky propozim u refuzua ngase ishte propozim i opozitës, dhe kështu që nuk kam si mos të përkrahi drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave që ndoshta do të ishte mirë që të ishte i gjithë Kuvendi i Komunës, edhe pse ishin përfaqësuesit e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, por nuk e besoj se do të prishte punë që të ishte edhe i gjithë Kuvendi, ashtu siç ditëm të presim me duartrokitje këtu delegacionin nga Gjermania do të ishte mirë të ishim bashkërisht edhe në vizitat dhe drekën e organizuar, por sido që të jetë kjo është fytyra e vërtetë e autoritetit të Kuvendit të Komunës së Podujevës gjegjësisht këshilltarit të Kuvendit të Komunës që mëkëmbet si të dëshirojnë të tjerët gjegjësisht të autoritetit më të lartë. E them këtë ngase mua personalisht nuk më erdhi mirë që nuk morëm pjesë të gjithë këshilltarët e Kuvendit, jo pse kemi mungesë të mjeteve për të ngrënë, sepse atë e bëmë edhe këtu në qytet, por delegacioni është delegacion dhe mikpritja është mikpritje.

Sa i përket Raportit Financiar për periudhën janar – qershor 2014, konsideroj se është që këtë raport e kemi para vetës ngase ky raport është transparencë dhe llogaridhënie e shpenzimit të parasë publike, është për keq ardhje që nuk kemi pasur raport tremujorë ngase do të kishim më të lehtë të gjendeshim në këtë të gjashtëmujorit dhe do të ishte më e mirë përcjellja e dinamikës së realizimit të projekteve që ky Kuvend i ka miratuar.

Duke pasur parasysh që para kësaj pike patëm Raportin e Auditorit të Përgjithshëm, dhe patëm një mori vërejtjesh dhe opinionesh që i bëmë, raporte të cilat janë të ndërlidhura njëra me tjetrën, dhe unë në vazhdim do të fokusohem në vetëm dy – tri çështje kryesore. Buxheti i Komunës është mbi 17 milion euro ndërsa deri më tani janë shpenzuar mbi 7 milion euro, mirëpo një gjë e cila më shtyri të bëjë vërejtje është se për gjashtë mujorin e parë të vitit, duke qenë në dijeni për kushtet klimatike se nuk është koha e përshtatshme apo vlugu i punëve, por nga një buxhet prej rreth 7 milion eurosh për investime kapitale,

të shpenzohen vetëm 1,300,000.00 €, si dhe me rishikimin e buxhetit bërë mbledhjen e kaluar kemi destinuar rreth 1 milion euro, kjo na tregon se Komuna e Podujevës nuk i ka punët mirë në realizimin e projekteve për të cilat është menduar se do të realizohen gjatë këtij viti. Vërejtja tjetër ka të bëjë me pjesën dërmuese të projekteve të cilat pasqyrohen sot para nesh si projekte të investuara ose të ekzekutuara për gjashtë mujorin e këtij viti, nuk di si ta quaj këtë, mashtrim më duket fjalë e rëndë, por të quaj pasqyrim real nuk mundem ngase pjesa dërmuese e këtyre projekteve janë të realizuara në vitin 2013, ndërsa këtu na paraqiten si punë të kryera brenda gjashtë mujorit të këtij viti, pra nuk do t'i përmendi me emër ato projekte por jemi dëshmitar që pjesa dërmuese e atyre projekteve të cilat janë kryer vitin 2013 tani në këtë raport pasqyrohen si projekte të përfunduara në periudhën janar - qershor 2014.

U përmend shumë Zyra e Prokurimit Publik për të cilën pati shumë vërejtje dhe kritika të cilat ishin të konstatuara edhe në Raportin e Auditorit të Përgjithshëm, për të cilën mendoj se me vet faktin që nuk ka dhe nuk paraqet asnjë herë plan të punës, dihet se mbetet në vullnetin e vetë zyrës që të anulon tenderë dhe gjëra të tjera, mirëpo çështjen të cilën nuk mund të kaloj pa e cekur, është riparimi i automjeteve, jemi në dijeni se Komuna jonë në vitin paraprak ka pasur të nënshkruar një kontratë me një operatorë për mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare, dhe në përfundim të asaj kontrate Komuna jonë ka shpallur tri herë tenderin për zgjedhjen e një operatori për mirëmbajtjen e automjeteve, e që tri herë është anuluar tenderi me arsyetime, nëse mund t'i quaj banale, duke përcaktuar kriterë ku një ndër ato ka qenë se operatori duhet të jetë 5 km afër Komunës, kriter i cili absolut është në kundërshtim me ligjin, ndërsa tenderi i fundit anulohet me arsyetim se Komuna është në procedurë të blerjes së veturave të reja dhe që nuk ka nevojë të riparoj veturat e vjetra, pra nuk i kam vetëm fjalë këto por kam edhe fakte të cilat janë lëshuar nga zyra e prokurimit, kurse tani në këtë raport na paraqitet një shumë prej 7,000,00 € që gjoja prapë janë riparuar veturat, jam në dijeni se veturat duhet të riparohen por shtrohet pyetja pse të anulohet tri herë tenderi dhe që tri herë i është anuluar një operatori i cili ka qenë me çmimet më të lira duke iu thënë se është më i liri dhe madje çmimet janë shumë të lira dhe jeni i papërgjegjshëm, ndërsa ai operator e ka ngritur çmimin ndërsa kur ka konkurruar me 33,000.00 € prapë është eliminuar me arsyetim se Komuna do të blej vetura të reja dhe nuk riparon vetura të vjetruara, ndërsa në këtë raport pasqyrohet që Komuna ka riparuar vetura të vjetra, pse ka ndodh kjo besoj se nuk nevojitet shumë imagjinatë për të ditur do të thotë se sigurisht nuk ka kaluar operatori i preferuar nga përzgjedhësit.

Çështje tjetër të cilën nga kjo foltore të paktën 7 – 8 herë e kam potencuar që e kemi gjendjen e keqe me ambientin dhe jemi duke e degraduar ambientin deri në atë masë sa që është bërë e vështirë të jetohet, ndoshta për ndokënd është anomali për këtë që po e them por është degraduar nga investimet e Komunës që janë bërë, sepse investohet në kanalizime pastaj ato kanalizime derdhen në lumenj të cilët janë shëndrruar në vija të hapura të kanalizimeve dhe sot të jeni të bindur se është bërë shumë vështirë të jetohet afër lumenjve tanë të cilët i kemi pasuri nacionale të Komunës, ndërsa për këtë çështje në kohën kur është përgatitur projektbuxheti e kam shtruar këtë çështje ku kam propozuar që të shtohet buxheti për dezinfektimin dhe derratizimin e hapësirave afër lumenjve ngase është bërë rrezik potencial për shëndetin e qytetarëve të jetosh afër lumenjve, ndërsa ato 20,000.00 € që kanë qenë të planifikuara për derratizim, dezinfektim dhe dezinfektim, sipas këtij raporti gjashtë mujor gjoja se janë shpenzuar ato

mjete për dezinfektimin e disa hapësirave, ndërsa për ato vende ku janë të rrezikuar qytetarët thuhet se nuk ka mjete financiare.

z. Bahri Selimi, theksoi, edhe Grupi i këshilltarëve të LVV-së, së bashku me ekspertë të subjektit ka analizuar këtë Raport financiar gjashtë mujorë, dhe kemi nxjerrë disa mangësi të cilat do t'i shprehi në vazhdim. Lidhur me kategorinë e shpenzimeve paga dhe mëditje, konsideroj se kjo është një rregull e cila praktikohet nga të gjitha institucionet dhe që ky shpenzim i buxhetit bëhet deshëm apo nuk deshëm ne, mirëpo çështja e cila ka të bëjë me investimet kapitale ku nga rreth 6 milion euro janë investuar vetëm 1,321,000.00 €, apo 22 %, na bënë një përshtypje negative ngase duke e pasur parasysh që Komuna e Podujevës ka nevojë për investime kapitale shumë më të mëdha se 6 milion euro e lëre më vetëm 1,321,000.00 €. Çështje tjetër e cila më bënë përshtypje negative është edhe kategoria subvencione dhe transfere ku kemi një shpenzim të buxhetit vetëm 22% të buxhetit të ndarë për këtë kategori ku nga 555,000.00 € janë shpenzuar vetëm 120,000.00 €, e që për këtë konsideroj se qytetarët e Komunës së Podujevës për subvencione kanë nevojë edhe më të madhe se shuma prej 555,000.00 €, e lëre më shumën 120,000.00 €.

Pra në total, nga një buxhet mbi 17,000,000.00 €, janë shpenzuar në gjashtë mujorin e parë të vitit 7,031,000.00 €, ku i bie 41% e buxhetit, dhe nëse vazhdohet me këtë ritëm të investimeve me siguri se në fund të vitit do të mbeten rreth 3 milion euro të pa shpenzuara. Gjithashtu shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, konsideroj se janë shpenzime të mëdha me një rritje prej 77%, gjë e cila në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar na bënë të kuptojmë se këtë gjashtë mujor zyrtarët e Komunës paskan qëndruar vetëm jashtë shtetit. Theks të veçantë i kemi kushtuar kategorisë, furnizime të pastrimit, ku duke bërë krahasim me periudhën e vitit të kaluar që ka qenë shuma prej 5,690.00 €, ndërsa tani 12,000.00 €, apo 114% më shumë se vitin e kaluar, gjë që i bie se vitin e kaluar nuk është bërë pastrimi i objekteve të Komunës fare. Sa i përket regjistrimit të automjeteve, është një rritje prej 18%, përkundër asaj që për sigurimet e automjeteve kemi ulje prej 52%, çështje e cila mund të ketë ndonjë keqkuptim ngase çdo automjet i cili regjistrohet ai duhet edhe të sigurohet, rregull e cila është e paraparë me legjislacionin e komunikacionit në fuqi. Po ashtu te shpenzimet e vendimeve të Gjykatave është një rritje shumë e madhe e shpenzimeve prej 730%, rritje e cila është katastrofale dhe nuk besoj se kanë kapacitet kaq të madh Gjykatat të punës së tyre që do të mund të rriste këtë përqindje kaq të madhe. Ndërtimi i rrugëve lokale, po ashtu ka rritje prej 77%, mandej kemi rritje të shpenzimeve në ndërtimin e trotuareve prej 2447% gjë të cilën nuk mund të kuptoj. Po ashtu edhe çështja, kapitale tjera, në raport përshkruhet një rritje e shpenzimeve prej 2051%, apo nga 695 € sa ishin në vitin e kaluar në periudhë të njëjtë, në këtë periudhë gjashtë mujore të këtij viti 14,955.00 €, është përshtypje e keqe ngase këto kapitale nuk janë të specifikuara dhe të detajuara ashtu siç duhet të jenë, prandaj na bënë të dyshohet.

Për të mos zgjatu më shumë në lidhje me raportin financiar për përdhën janar – qershor 2014, ne si Grup nga subjekti politik Vetëvendosje mbetemi me shpresën që në raportin tjetër gjashtë mujor shpenzimet do të jenë më efikase dhe më të detajuara.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, rreth këtij raporti unë më shumë do të ndalem në disa pika ku shpenzimet e tejkalojnë normën e investimeve dhe pagesave që janë bërë për investime për këtë gjashtë mujorë dhe të cilat për këtë periudhë janë shqetësuese, duke filluar te shpenzimet e telefonisë mobile dhe fikse ku janë bërë pagesa 10,922.00 €, duke

qenë në dijeni se brenda institucionit të Komunës zyrtarët i kanë telefonat fikse, kurse të paguhen 6200.00 € për telefoni mobile dhe 4690.00 € për telefoni fikse, konsideroj se janë shpenzime të panevojshme dhe është shqetësuese kjo shifër. Sa i përket furnizimit me ushqim dhe pije ku rreth 5000.00 € janë bërë pagesa vetëm për këtë gjashtë mujor, si dhe janë bërë pagesa në shumë 63.84%, ose rreth 87,000.00 € për dru, por duke pasur parasysh kushtet atmosferike dhe dimrin që patëm këtë vit mendoj se është shumë shqetësuese kjo shifër. Gjithashtu për mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare shifrat të cilat janë shpenzuar janë shqetësuese sikurse që janë edhe ato të shpenzimeve të vendimeve të Gjykatave pre 730%. Po ashtu te të hyrat vetanake pagesa përmes listës së pagave, jemi në dijeni për punësimet që janë bërë pa kontrata kohëve të fundit në sektorin e shëndetësisë, pagesa të cilat bëhen nga të hyrat vetanake të cilat i menaxhon Komuna dhe ato të hyra nuk mund të destinohen dhe shpenzohen tjetër kund përveç në sektorin e shëndetësisë, por ne i kemi cekur edhe në seancat e kaluara se ka punëtorë në shëndetësi që u është vazhduar kontrata deri në 12 muaj në vende të caktuara të cilët në vendet e tyre të punës nuk guxojnë të kryejnë asnjë trajtim mjekësorë për arsye se diplomat e tyre janë të dyshuara dhe të panostrifikuara, mirëpo edhe punësimet e tyre në këtë gjashtë mujorë janë bërë pa konkurs fare, kështu që këto pagesa kanë mbërritur shumën 38,714.00 € shumë e cila është shqetësuese. Po ashtu përshtypje më ka bërë një pagesë e kryer për punën e kryer në vitin 2010 në mesin ku unë jetoj në fshatin Dyz, ku Kompanisë Malësia ju kanë paguar 2665.00 € në vitin 2014 kurse puna është kryer në vitin 2010, fjala është për rrugën në lagjen Rrmoku te bungu i Dyzit ku ajo rrugë ka qenë investim i Qeverisë së Kosovës ku pjesë e asfaltimit të asaj rruge kemi qenë edhe ne si pjesë e asamblesë së Partisë Demokratike të Kosovës, ndërsa pagesa nga Komuna e Podujevës është bërë në vitin 2014 gjë që mendoj se është dëmtuar buxheti i Komunës së Podujevës kështu që mendoj se deri në fund të vitit Drejtoria e Buxhetit dhe Financave nuk do t'i ketë punët mirë sa i përket parasë publike. Çështje tjetër është pagesa Gentit për kryerjen e punëve emergjente gjatë vërshimeve në shumë 10,000.00 €, ku ne e kemi pasur një raport nga Drejtoria përkatëse për çështjen e vërshimeve dhe atëherë kemi pyetur pse nuk ka pasur angazhim më të madh, ndërsa përgjigjja nga drejtori ka qenë se ne e kemi pasur të mobilizuar vetëm një skip në tërë territorin e Komunës dhe nuk kemi pasur mjete të mjaftueshme për të ndërhyrë më shpejt, kurse në këtë raport është cekë një shumë e paguar prej 10,000.00 € që është bërë në kohën e vërshimeve, ndërsa e njëjta kompani 7460.00 € i ka marrë në vitin 2013, e duke pasur parasysh se vitin e kaluar ka qenë një thatësi totale është bërë pagesë mbi 7460.00 € për kryerje të punëve emergjente, gjë e cila nuk është në rregull.

Pra kërkoj përgjigje nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave për çështjet që i ngrita për fshatin Dyz, dhe për pagesën e Gentit.

z. Fatmir Rudari, theksoi, raportin financiar për periudhën janar – qershor 2014 e kam analizuar dhe duke mos dashur t'i ritheksuar të gjitha ato që i përmenden parafolësit unë do të ndalem vetëm në fushën e arsimit ku kam vërejtur se në këtë raport nuk parashihet asnjë trajnim për mësimdhënësit gjë për të cilën mendoj se është shumë e rëndësishme të ketë trajnime, ndërsa për objekte arsimore janë të cekur rreth 41,000.00 € dhe këto projekte janë kryer në vitin 2013 siç janë shkollat, "Hasan Ramadani" në fshatin Shajkoc dhe shkolla e fshatit Siboc, projekte të cilat kanë përfunduar në vitin 2013, ndërsa pasqyrohen në këtë raport financiar gjashtë mujor të vitit 2014. Duke pasur parasysh se nevojat janë të mëdha për shkollat e Komunës së Podujevës, si uji i pijes, pastërtia në

objekte shkollore dhe shumë nevoja tjera, si dhe nevoja për renovimin e shumë shkollave siç e kemi rastin e shkollës në fshatin Sekiraqë e cila është ndërtuar nga komuniteti i fshatit dhe që 15 vite nuk ka renovim të asaj shkolle. Gjithashtu shprehi pakënaqësi edhe në konkursin për mësimdhënës të cilin këto ditë e ka shpallur Drejtoria e Arsimit, konkurs me të cilin janë fshehur shumë orë të cilat me siguri se ruhen për aktivistë të subjektit politik që qeverisë në Komunën tonë, unë pata një pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Arsimit, por meqë drejtori nuk është prezent këtu atë do të lë për një seancë tjetër.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, nuk dëshiroj të hyjë në esencë të këtij raporti, por mora fjalën me qëllim që ti bëjë dy apo tri pyetje drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave si dhe t'i paraqesë dy apo tri konstatime të nxjerra nga ky raport financiar i Komunës së Podujevës për përdhën janar – qershor 2014. **z. Naim Çunaku** e tha se kushtet atmosferike na bëjnë që të kemi konsideratë që janë investuar vetëm 20% e investimeve kapitale, mirëpo si duket gjatë tërë këtij viti do të kemi mot me shira, e që kanë mbetur edhe 80% të investimeve kapitale të realizohen.

Komuna gjithashtu investon në rrjetin e ujësjellësit dhe kalalizimit, normalisht për nevoja të qytetarëve, mirëpo ne kemi dy Ndërmarrje Regjionale Publike, Kompaninë e Ujësjellësit dhe Kompaninë e Pastrimit, Kompani të cilat qytetarët e Komunës së Podujevës i faturonjë dhe inkasojnë mjete financiare nga ne, do të thotë këto dy Kompani inkasojnë mjete nga qytetarët e Komunës së Podujevës ndërsa Komuna jonë nga buxheti i vet investon në rrjetet e tyre, nuk jam në dijeni se a ka apo nuk ka Komuna jonë nga një përfaqësues në bordet e këtyre Ndërmarrjeve Regjionale por jam në dijeni se do të duhej të ketë, e them këtë ngase konsideroj se do të ishte mirë që ne si regjion ku operojnë këto Kompani të kemi raporte financiare nga ato Kompani në mënyrë që të shohim se sa kanë përfitime dhe sa mjete inkasojnë nga ky regjion ngase nuk e kam të qartë se si ato Kompani bëjnë afarizëm në regjionin e Komunës së Podujevës dhe inkasojnë mjete financiare dhe a ndajnë ndonjëherë ndonjë pjesë të fitimit të tyre për buxhetin e Komunës së Podujevës, gjithëherë për nevojat e qytetarëve tanë. E vërteta është që është investuar shumë në rrjetin e kanalizimit dhe ky investim shpeshherë ka rrezikuar shëndetin e qytetarëve të Komunës tonë ngase janë degraduar në shkallë shumë të lartë lumenjtë e Komunës, gjithashtu edhe Kryetari i Komunës tonë ka premtuar se do të angazhohet shumë për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në Komunën tonë, ndërsa me këtë premtim unë nënkuptoj zhvillimin ekonomik të Komunës duke ruajtur ambientin, por jo në dëm të ambientit ngase nuk do të ishte i qëndrueshëm pastaj.

Pyetjet për drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave janë, në lidhje me të hyrat vetanake, a ju dërgohen fatura obliguesve tatimorë ndonjëherë për obligimet vjetore që kanë për tatimin në pronë, dhe pyetja tjetër është, a ka ndryshime në vlerën e obligimeve të njëjtat familje nga e njëjta zonë prej viti në vit. Unë nuk kam marrë asnjëherë ndonjë faturë, dhe sa kam biseduar me shumë qytetarë asnjëherë nuk dërgohen faturat vjetore të tatimit në pronë, mirëpo si duket është krijuar një praktik që vetëm atëherë kur iu paraqitet nevoja qytetarëve tanë detyrohen t'i paguajnë ato obligime tatimore, do të thotë detyrohen ta paguajnë tatimin në pronë me kryerje të shërbimeve.

z. Naim Çunaku, theksoi, mora fjalën të jap një sqarim në lidhje me potencimin e parafolësit i cili si duket në lidhje me përqindjen e investimeve kapitale dhe kushtet atmosferike më ka kuptuar në atë mënyrë ashtu siç ai e tha, por unë tani do të jap një sqarim ngase ndoshta më ka kuptuar edhe ndokush tjetër në atë mënyrë, unë në diskutimin tim e thash, se kur e kemi parasysh që në gjashtë mujorin e parë të viti nuk

është vlugu i investimeve kapitale, nuk e thash se është e arsyeshme që është investuar vetëm 1 milion euro nga 7 milion euro, sa janë për investime kapitale, pra për të mos pasur keqkuptime po e theksoi edhe një herë se edhe ai 1 milion euro që është investuar në këtë gjashtë mujor të parë të vitit janë projekte të realizuara në vitin 2013 ndërsa në këtë vit nuk është investuar fare, kështu kam dashur të them.

z. Kadri Avdiu, theksoi, lidhur me Raportin financiar për periudhën janar – qershor 2014 parafolësit thuajse në përgjithësi i ceken të gjitha dobësitë dhe lëshimet e bëra. Realisht ky raport është sjell para nesh për të na pasqyruar investimet që janë bërë brenda kësaj periudhe por në realitet në bazë të përshkrimeve të raportit unë shoh se deri më tani janë paguar vetëm borxhe të vitit 2013, por ka edhe pagesa të borxheve të katër viteve më parë, ndërsa nuk bëhet fjalë as për 20% të investimeve në vitin 2014.

Çështja që më së shumti më ka bërë përshtypje është, 730% rritje të shpenzimeve për vendimet Gjyqësore, gjë e cila është për habi, por me siguri se deri te kjo situatë ka ardhur nga lajkat që janë bërë duke u munduar tu shmangen përgjegjësi, dhe natyrisht se ka ardhur deri te kallëzimet penale. Gjithashtu për blerjen e druve në raport me periudhën e njëjtë të vitit paraprak arrihet shuma e mjeteve të shpenzuara prej 63% më e madhe, pastaj për derivate për gjeneratorë arrihet shuma 53% më e madhe se në periudhën e njëjtë të vitit 2013, pra këto janë disa shifra dhe përqindje për të cilat duhet të habitemi. Nuk mund të mos e përmendi edhe dezinfektimin, derratizimin dhe dezinfektimin, çështje të cilën e përmendi edhe z. Naim Çunaku, e që në raport ceket se janë harxhuar të gjitha ato mjete të parapara dhe është bërë përskatja e parkut të qytetit.

z. Flakron Gashi, theksoi, desha të ndalem vetëm te pagesat për vitin 2014 te kategoria projekte dhe investime kapitale ku në faqen 13 të raportit ceket një shumë prej 1,218,230.88 €, dhe që është për habi ku vetëm tri kompani kanë marrë projekte në vlerë afër 500,000.00 €, gjë e cila sikur koencidon me diçka tjetër. U tha këtu nga disa parafolës se shumica e këtyre projekteve të cilat ndoshta shumica prej tyre janë paguar në këtë vit ndërsa punët janë kryer në vitin 2013, e kjo i bie sikur kthim i nderit për shërbimin që u kanë bërë gjatë fushatës zgjedhore, si dhe kjo çështje lidhet drejtpërsëdrejti me rekomandimet që janë bërë në Raportin e Auditorit të Përgjithshëm sepse Prokurimi nuk është në rregull.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, duke shpresuar se nuk do të ketë polemika do t'i jap disa sqarime dhe përgjigje të disa pyetjeve, sa i përket pyetjes që bëri z. Rafet Llapashtica rreth pagesës së Gentit në fakt është një kontratë e vitit 2014 dhe se vërsimet kanë ndodhur në këtë vit, por janë dy burime të pagesave të të njëjtës kontratë ku 10,000.00 € janë nga granti Qeveritarë dhe shuma 7,460.00 € është pagesë nga të hyrat vetanake. Sa i përket çështjes që të cilën e ngriti z. Lutfi Rexhepi rreth investimeve në rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimit, është e vërtetë që Komuna investon në rrjetin e Kanalizimit ngase po të kishte pritur që kjo Kompani Publike përkatëse të investon në këtë rrjet me siguri se nuk do të kishim asnjë km rrjet të ndërtuar të kanalizimit, për këtë ka bërë përpjekje edhe Komuna e Prishtinës por që nuk ka pasur efekt, ndërsa sa i përket ujësjellësit e njëjta gjë qëndron edhe me kompaninë e ujësjellësit, ne që tri vite kemi reduktuar buxhetin dhe kemi pasur vërejtje këtu nga njëherë se përse nuk ndahen mjete për zgjerim të rrjetit të ujësjellësit gjë të cilën e kemi sqaruar disa herë dhe kemi dhënë arsyet tona edhe pse ato asete mund të jenë të diskutueshme se a i takojnë Komunës apo kompanisë, por megjithatë janë qytetarë të Komunës tonë, dhe po të kishim mundësi ne do të ndërtonim rrjet të ujësjellësit në qoftë

se kompania përkatëse do të bënte furnizimin me ujë të pijes për qytetarët e Komunës së Podujevës, mirëpo tani për tani nuk është ajo mundësi.

Nga disa këshilltarë pati frikë se dinamika e shpenzimeve dhe dinamika e punëve është më e ngadalshme apo që jemi larg realizimit të suksesshëm të buxhetit, ndërsa unë them se realizimi i buxhetit mund të jetë realizim 100% dhe mos të jetë i suksesshëm dhe nuk nënkupton që çdo shpenzim është rezultat i mirë, ndoshta ndonjëherë më mirë është të mbetet buxhet suficit se sa të jetë shpenzim jo i arsyeshëm. Sa i përket Drejtorisë që unë e udhëheqë mund t'ju them se çdo ditë e përcjell punën dhe shpenzimin e buxhetit ku deri në fund të muajit korrik është shpenzuar rreth 50% ku në krahasim me vitet tjera është më herët, pavarësisht që dua të jem real që këtë vit kemi pasur kohë më të vështirë posaçërisht për punët e jashtme siç janë kanalizimet etj. që kemi raste kur duhet të presim për të filluar me punime. Do të thotë se këtë vit shumë shpresoj që me këtë dinamikë të punimeve do të realizohet buxheti edhe më herët se viteve tjera.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, sa i përket kategorisë subvencione dhe transfere për të cilën u tha se është investuar më pak se që është dashur të bëhet, ky zvogëlim realisht është ndikuar nga ndarja e bursave të nxënësve dhe studentëve për shkak se ato janë paguar tani në muajin e shtatë ngase është dashur të pritët derisa të ndahen bursat nga niveli qendrorë në mënyrë që të mos të kemi rast ku ndokush do të merrte dy bursa e ndokush do të mbetej pa asnjë, edhe nga niveli lokal dhe ai qendrorë, pra fjala është për një shumë prej 50,000.00 € të cilat janë shpenzuar në muajin e shtatë e të cilat nuk pasqyrohen në këtë raport ngase raporti është për gjashtë mujorin e parë, si dhe për subvencione në bujqësi paraqiten disa telashe ngase të gjitha procedurat duhet të udhëhiqen përmes Prokurimit dhe normalisht se disa nga ato kanë edhe vonese procedurale, ndoshta do të ishte më mirë të shpenzohej një shumë më e madhe por konsideroj se çështja kryesore është te ndarja e bursave, ndarje e cila është vonuar pak sa. Lidhur me shpenzimet për udhëtime zyrtare jashtë vendit, në këtë vit kemi një ngritje të lehtë ngase Kryesuesi i Kuvendit bashkë me një grup tjetër, me agjendë dhe ftesë të nivelit qendrorë, kanë pasur disa vizita pune në Shqipëri.

Po ashtu u përmend sigurimi i automjeteve, e vërtetë është që paraqitet një diskrepancë në raport me regjistrimin e tyre ngase sigurimi i automjeteve automatikisht bëhet para se të regjistrohen por është me kontratë, kemi raste ku operatori ekonomik mund të vonohet me fatura apo ndonjëherë mund të mos ketë mjete dhe vonohet pagesa, kurse jeni në dijeni se për të regjistruar një automjet është kusht që të bëhet sigurimi.

Sa i përket faturave të tatimit në pronë është një rregull të cilën e zbatojnë shumica e Komunave të Kosovës në bashkëpunim me Ministrin e Financave e cila bëhet përmes postës, përgatitet databaza prej Ministrisë së Financave – Departamenti i tatimit në pronë dhe vetëm merret pëlqimi nga Komunitat për shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë përmes postës, dhe ne nëse e japim pëlqimin atëherë duhet të nënshkruhet një kontratë mes Komunës dhe Postës, për shpërndarjen e faturave të tatimit në pronë, pra kjo dukuri është duke vazhduar që 5 vite radhazi, mendoj se problemi qëndron që këto fatura nuk dërgohen me rekomandë në mënyrë që ne do të kishim një konfirmim të pranimit të faturave nga ana e qytetarëve, t'ju them të drejtën këtë vit nuk ka pasur ankesa nga qytetarët për mos dërgim të faturave të tatimit në pronë, ndërsa vitin e kaluar ka pasur shumë ankesa çështje të cilën e kam alarmuar dhe me një shkresë iu kam dërguar Postës së Kosovës - Drejtorisë përkatëse ku kam shprehur shqetësimin tim dhe

shqetësimin e qytetarëve të cilët më kanë thënë se faturat e tatimit në pronë hidhen në lumin Llap dhe në shporta e mbeturinave, këtë opinion e kam paraqitur në atë shkresë, dhe Posta e Kosovës gjithashtu e ka alarmuar këtë çështje dhe ka ndërmarr masa deri te postierët e nivelit lokal të cilët kanë pasur për obligim të shpërndajnë ato fatura, pastaj kemi formuar komision të përbashkët me njësinë lokale të Postës, me qëllim që të dalim nga kjo situatë e krijuar, kemi bërë anketime të qytetarëve në ato mese nga ka pasur më së shumti ankesa. Pra nëse nuk arrijnë faturat e tatimit në pronë në adresën përkatëse është përgjegjësi e shërbimeve të Postës ndërsa e mate e kësaj është se faturat nuk dërgohen me rekomandë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për diskutim, do të mundohem të bëjë një rezymë të shkurtër ngase në mandatin e kaluar kam qenë drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit dhe jam në rrjedha për disa projekte të investimeve kapitale. Pagesat të cilat janë bërë në këtë vit kanë të bëjnë me 4 apo 5 projekte të cilat kanë qenë projekte dy vjeçare, përkatësisht, asfaltimi i rrugëve në qytet, asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Llapashticë, si dhe projektet për fshatrat Dumnicë dhe Balloc, projekte të cilat kanë filluar në vitin 2013 me aq mjete sa ka pasur ndërsa vazhdohet edhe këtë vit, do të thotë se shumica e atyre pagesave janë bërë për këto projekte dy vjeçare.

Ky raport nuk është i obliguar t'i nënshtrohet procedurës së votimit, mirëpo për të qenë sa më transparente puna e Kuvendit, unë e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se me 14 vota për, 12 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur, miratohet Raporti financiar i Komunës për periudhën janar – qershor 2014

5. Miratimi i propozimit të Rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kushtet e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa njëzëri i kemi rekomanduar Kuvendit për miratim për shkak se është e nevojshme që Rregullorja përkatëse të ndryshohet dhe të plotësohet ngase ka qenë e hartuar në bazë të organogramit të vjetër dhe tani kërkohet të harmonizohet me organogramin e ri, andaj e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri miratohet propozim Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kushtet e bllokimit dhe zhvendosjes së automjeteve.

6. Propozimi i vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (sipas kërkesave të Ejup Jasharit – Balloc, Hamit Hamitit – Reçicë dhe Muharrem Isufit – Majac)

Pas votimit u konstatua se njëzëri miratohen tri propozimet e vendimeve për destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas kërkesave të Ejup Jasharit nga fshati Balloc, Hamit Hamitit nga fshati Reçicë dhe Muharrem Isufit nga fshati Majac.

7. Rishqyrtimi i vendimit nr.01-119-61160 i miratuar në Kuvendin e Komunës më datë 18 korrik 2014, për kompensimin e punëve dhe angazhimeve të Komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jeni në dijeni se në mbledhjen e kaluar të Kuvendit kemi miratuar vendimin përkatës, por gjatë procedurës së votimit ku kemi votuar edhe ne disa këshilltarë të Kuvendit dhe unë si Kryesues i Kuvendit e të cilët jemi edhe anëtarë të Komisionit përkatës, është dashur të lëshojmë sallën e Kuvendit ngase ka qenë konflikt interesi votimi edhe nga ana jonë që kemi votuar për vete, pastaj këtë e kam vërejtur dhe jam konsultuar me Kryetarin e Komunës i cili ka kërkuar që ky propozim vendim të kthehet në rishqyrtim në mënyrë që të jetë në harmoni me ligjin. Andaj unë e ftoj z. Shaban Osmanin si anëtari më i vjetër i këtij Kuvendi të kryesoi mbledhjen përderisa ne të dalim nga salla në mënyrë që të mos marrim pjesë në votimin e këtij propozim vendimi.

Konstatohet se me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit, përkohësisht në mbledhje nuk morën pjesë, Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Kadri Avdiu, Naim Çunaku, Bahri Selimi dhe Lutfi Rexhepi, dhe njëkohësisht u konstatua se, ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

z. Shaban Osmani, Kryesues ad-hoc i Kuvendit, theksoi, vendimin përkatës e kemi miratuar në mbledhjen e kaluar vendim për të cilin konsideroj se nuk nevojë për sqarime ngase të gjitha rreth kësaj pike të rendit të ditës u shpjeguan nga Kryesuesi i Kuvendit, gjithashtu kuorumi u konstatua, andaj nëse nuk ka të interesuar për të marr fjalën, më mbetet vetëm të hedh në votim rishqyrtimin e vendimit nr.01-119-61160 i miratuar në Kuvendin e Komunës më datë 18 korrik 2014.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua vendimi.

8. Propozimi i vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsiderojmë se është e nevojshme që të ngritët komisioni për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim.

Sipas legjislacionit përkatës ky komision përbëhet nga 5 anëtarë, ku 2 anëtarë i propozon Ekzekutivi i Komunës, ndërsa pjesa tjetër mund të plotësohet me një anëtarë nga pozita, një nga opozita, si dhe një nga shoqëria civile, mendoj se mjafton që ky komision të përbëhet prej 5 anëtarëve.

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, vendimi për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim është përcaktuar me ligjin për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, mirëpo në Udhëzuesin e dhënies së pronave të Komunës në shfrytëzim parashihet në mënyrë decitive përbërja e këtij komisioni, ku

thuhet se komisioni duhet të përbëhet prej 5 anëtarëve ku 2 prej tyre i propozon Ekzekutivi i Komunës, 2 nga Kuvendi i Komunës dhe 1 anëtarë nga shoqëria civile.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nga Ekzekutivi i Komunës, më është dorëzuar me shkrim anëtarët e propozuar për këtë komision, dhe atë, z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, dhe z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Një anëtarë mund ta propozoj Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, si subjekti më i madh i përfaqësuar në Kuvend.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e subjektit politik LDK, për anëtare të komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim, e propozoj z. Fatlume Jaha.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, tani mbetet të propozohet edhe një anëtar për këtë komision, dhe ai mund të bëhet nga subjekti më i madh opozitarë i përfaqësuar në Kuvendin e Komunës i cili është Partia Demokratike e Kosovës.

z. Naim Çunaku, theksoi, para se ta bëjë propozimin e anëtarit nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së, dua t'i them se ne gjithëherë e kemi përkrahur dhe kemi kërkuar që pronat komunale të identifikohen, të jenë publike për qytetarët e Komunës së Podujevës dhe që Kuvendi ta merr një vendim që gjitha ato prona Komunale të cilat janë në interes të qytetarëve për tu shfrytëzuar, të qiten në ueb-faqen zyrtare të Komunës dhe të jenë të disponueshme për të gjithë investitorët e mundshëm gjegjësisht për të gjithë ata njerëz të cilët dëshirojnë t'i kenë në shfrytëzim. Jemi në dijeni se disa prona komunale janë dhënë në shfrytëzim sipas një rregulloreje të vjetër të Kuvendit, ngase nuk ka pasur ligj për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim.

Do të kishte qenë mirë që në një të ardhme të afërt Ekzekutivi i Komunës të përgatit një regjistër me të gjitha pronat e Komunës, ato të cilat janë në shfrytëzim, nga kush shfrytëzohen, dhe, sa dhe si janë kontratat e tyre, në mënyrë që të kemi një pasqyrë reale për të gjitha pronat e Komunës së Podujevës.

Ne kemi marr disa hapa për dhënien e disa pronave komunale në shfrytëzim, por kemi ngecje në infrastrukturën ligjore gjegjësisht në hartimin e një rregulloreje për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, në bazë të të cilës do të rregullohen kriteret, çmimin e ofertimit dhe formën se si jepen pronat komunale në shfrytëzim dhe gjitha çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me këtë çështje.

Ne si Kuvend e kemi ngritur Komisionin për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, ku pjesë e këtij komisioni jam dhe unë, dhe konsideroj se ky komision ka për obligim ligjor dhe moral të raportoj para Kuvendit, pra para pak javësh ne si komision kemi filluar me procedurat e dhënies së pronave të Komunës në shfrytëzim, dhe në fillim të kësaj mbledhjeje në një formë u dakorduam që në një mbledhje të ardhshme të paraqitet një raport para Kuvendit për, formën, mënyrën, rregullsitë apo edhe parregullsitë nëse ka dhe procedurat e dhënies së disa pronave të Komunës në shfrytëzim. Pra nuk do të lëshohem më shumë rreth kësaj çështjeje ngase me siguri se do të kemi një raport nga ky komision i cili është takuar një herë në hapjen e ofertave për dhënie në shfrytëzim të disa pronave, takim ku kemi pasur vërejtje rreth hapjes së ofertave dhe në kushtet dhe kriteret e përcaktuara.

Ne Grupi i këshilltarëve nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës, për anëtarë të komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim, e propozojmë z. Rafet Llapashtica.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, rreth kësaj çështje, neni 8 i ligjit për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim e rregullon këtë çështje ku në mënyrë specifike thotë që Kryetari i Komunës propozon 3 anëtarë, 3 anëtarë nga subjektet e përfaqësuar në Kuvendin e Komunës dhe 1 anëtarë nga shoqëria civile, kështu që propozoj që të përfshihet edhe Lëvizja Vetëvendosje dhe ta propozoj edhe ky subjekt anëtarin e tyre në këtë komision, pra konsideroj se nuk mund t'i mohohet asnjë subjekti politikë të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës që ta ketë anëtarin e vetë në kuadër të komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim.

Mendoj se çdo Grup i këshilltarëve të Kuvendit duhet të ketë përfaqësuesin e vet në secilin komision apo përfaqësim tjetër sikurse që e kanë në Komitetet obligative dhe në komisionet tjera të Kuvendit, ngase kjo çështje rregullohet me të gjitha aktet normative në fuqi, pra propozoj që edhe Vetëvendosje të ketë përfaqësuesin e vet në këtë komision.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne nuk jemi dhe nuk kemi qenë asnjëherë kundër përfaqësimit të një subjekti apo subjektit tjetër në komisione apo Komitete, mirëpo Udhëzuesi përkatës në mënyrë decitive e parasheh ashtu siç e ceka më parë, andaj nuk mund të veprojmë kundër këtij Udhëzuesi.

z. Bahri Selimi, theksoi, ne kemi themeluar në këtë Kuvend komisionin për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, komision i cili është themeluar në proporcion me Grupet e këshilltarëve të Kuvendit ku edhe ne si LVV përfaqësohemi me një anëtarë. Andaj mendoj se do të ishte në rregull që të përfaqësohemi edhe në komisionin për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim, ngase konsideroj se komisioni do të ishte më i fuqishëm, e them këtë ngase në këtë rast kur thuhet, opozita, nuk përfshihet subjekti më i madh apo subjekti më i vogël i përfaqësuar në Kuvend, por përfshihen të gjitha Grupet e këshilltarëve të Kuvendit pavarësisht numrit të tyre.

Pra Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje me plot të drejtë kërkon që të përfaqësohet në këtë komision, do të ishte mirë që të përfshiheshin të gjitha subjektet politike në këtë komision, por nëse ajo nuk është e mundur, ne kërkojmë që të jemi të përfaqësuar në cilësinë e subjektit në opozitë.

Gjithashtu në cilësinë e anëtarit të komisionit për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim kërkoj nga Drejtoria përkatëse që të përgatit një listë për këshilltarët e Kuvendit me të gjitha pronat komunale të cilat janë të dhëna në shfrytëzim. Ne si komision kemi pasur rastin të takohemi në hapjen e ofertave për tri prona të Komunës dhe vërejtëm se nuk shkoi gjithçka në rregull, mirëpo pres që të kemi një raport nga Drejtoria përkatëse dhe nga komisioni përkatës rreth dhënies në shfrytëzim të atyre tri pronave në mënyrë që të kemi një debat në Kuvend.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës ne e shohim të domosdoshëm themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim, ngase me siguri se do të ketë ankesa nga konkurrentët.

Pra unë bëra dy kërkesa për të cilat kërkoj që të merren parasysh, ndërsa për anëtarë të komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim, nga radhët e Grupit të këshilltarëve të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, propozojmë z. Adelinë Stublla.

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, mora fjalën me qëllim që të jap një sqarim rreth përfaqësimit në këtë komision, me gjithë respektin për Lëvizjen Vetëvendosje e cila shpreh dëshirë për tu përfaqësuar me një anëtarë në këtë komision, në Udhëzuesin përkatës parashihet që ky komision të përbëhet prej 5 anëtarëve si dhe një gjë të cilën nuk e përmenda më parë është se edhe përfaqësuesin e shoqërisë civile e cakton Kryetari i Komunës, pra nuk është bërë kjo rregull vetëm për Kryetarin e Komunës tonë z. Agim Veliu por këto rregulla janë bërë për të gjithë Kryetarët e Komunave të Kosovës.

Sa i përket përgatitjes së listës së pronave komunale të cilat janë aktualisht në shfrytëzim dhe të gjitha pronave komunale, unë kërkoj falje ngase kam qenë në pushim dhe nuk kam mundur të përgatiti për këtë mbledhje, mirëpo shumica nga këshilltarët e Kuvendit janë në dijeni se në mandatin e kaluar unë e kam ofruar në Kuvend një listë të të gjitha pronave komunale, dhe edhe në këtë mandat me siguri se do t'jua ofroj, jemi duke punuar në këtë drejtim dhe besoj se në mbledhjen e radhës do t'ua sjell një listë gjithëpërfshirëse duke përfshirë edhe objektet të cilat janë të dhëna apo që presin të jepen në shfrytëzim.

Sa i përket procedurave të dhënies së tri pronave komunale në shfrytëzim të cilat janë bërë para pak javësh unë them se nuk ka pasur kurrfarë shkeljesh dhe se është vepruar ashtu siç parashihet me ligjin përkatës i cili është respektuar në përpikëri, mirëpo këtu u tha se ka pasur pa rregullsi ndërsa unë them se nuk ka pasur parregullsi por ka pasur tendenca nga disa ofertues për të penguar punën e komisionit.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, kërkoj të më sqaroj ndokush, ngase thuhet se Kuvendi i Komunës ngritë një komisionit për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim, ndërsa ky komision përbëhet me një shumicë jashtë Kuvendit të Komunës, pra dëshiroj të dijë se a paraqet diskrecion ky komision, që të vendos për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim apo ky komision do të informon Kuvendin e Komunës, dhe Kuvendi të vendos. Andaj nëse komisioni ka diskrecion për të vendosur atëherë nuk është komision i Kuvendit ngase përbëra jashtë Kuvendit e përbën shumicën e anëtarëve të Kuvendit.

Jam në dijeni se do të ketë ankesa për procedurat e dhënies në shfrytëzim të disa pronave të Komunës, tash së fundi, e them këtë ngase më janë paraqitur ankesa nga disa individ, do të thotë ka pasur shkelje dhe nuk janë përfillur procedurat, e them këtë ngase jam në dijeni se pronat apo objektet të cilat kanë qenë të publikuara për tu dhënë në shfrytëzim, nuk u është lejuar palëve të shohin sepse kanë qenë të mbyllura, si dhe kam vërejtje që një objekt me 70m², të jetë i barabartë me një objekt me 700m² në qendër të qytetit, pra konsideroj se ka elemente të dyshimit dhe se sigurisht që për këto objekte ka synim ndokush t'i kontrabandoi, mirëpo për të mos i pasur këto dileme është mirë të qartësohet se a vendos komisioni apo komisioni e përgatitë materialin për Kuvend që të vendos Kuvendi, prandaj kërkoja sqarim se Komisioni për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, a është komision i Kuvendit apo komision i Komunës, prandaj edhe e bëra këtë pyetje ngase më krijoj dilemë, por nuk jam që të anashkalohen ligjet dhe aktet tjera të cilat e rregullojnë këtë fushë.

z. Haki Rudari, theksoi, pajtohem me parafolësin i cili në një rast e tha që komisioni për shqyrtimin e ankesave të palëve në procedurën e dhënies së pronës së paluajtshme në shfrytëzim, ashtu siç u paraqit përbërja e tij po mbetet pakicë për nga numri i përfaqësuesve të Kuvendit. Por unë mendoj se ky komision do duhej të përbëhet prej 7 anëtarëve pasi që komisioni për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim përbëhet

prej 7 anëtarëve. Gjithashtu pajtohem me z. Rafet Llapashtica i cili e sqaroi se përfshirja në këtë komision bëhet nga përfaqësues të Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, andaj unë bëj pyetje se kujt i pengon që Lëvizja Vetëvendosje të ketë në përbërje të këtij komisioni një anëtar.

z. Avni Ajeti, theksoi, megjithëse nuk jemi të njoftuar për kriteret e përcaktuara për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, mirëpo më bën përshtypje që para disa viteve disa persona të cilët kanë aplikuar në atë ankand për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim, jemi dëshmitar që ata persona ka tentuar në mënyrat më të parregullta që ato prona ti përvetësojnë duke paraqitur dokumente të dyshimta, ndërsa tani të njëjtit aplikojnë pa kurrfarë kriteresh, andaj kërkoj të më sqaroi ndokush se a ka kritere për ato prona dhe cilat janë ato.

z. Naim Çunaku, theksoi, faktikisht ne e kemi Ligjin përkatës dhe Udhëzuesin përkatës para vetës, mirëpo këtij Kuvendi asnjëherë nuk iu ka paraqitur para vetës një propozim rregullorë në bazë të së cilës do të sqaroheshin të gjitha detajet të cilat u përmenden nga disa parafolës. E them këtë ngase një rregullorë do të specifikonte dhe do të detajisonte kushtet e dhënies së pronave komunale në shfrytëzim.

Në mandatin e kaluar kemi debatuar për dhënien e pronave të Komunës në shfrytëzim dhe që atëherë ka pasur një propozim nga z. Ismajl Abdullahu, sa më kujtohet, që atyre individëve të cilëve iu janë dhënë prona komunale në shfrytëzim dhe të cilët nuk i kanë shlyer obligimet ndaj Komunës, të mos iu mundësohet të aplikojnë fare.

Prandaj ne për të diskutuar për rregullimin e kësaj çështjeje, duhet të hartojmë një rregullorë ngase për dhënien e pronave të komunës në shfrytëzim afatshkurtër kërkohet që të nxjerrët një akt nënligjor gjegjësisht rregullorë, ndërsa për dhënie në shfrytëzim afatgjatë janë tjera procedura dhe nuk mund të anashkalohet Kuvendi.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë u dhanë shumë sqarime nga disa këshilltarë të Kuvendit por edhe nga drejtori i Drejtorisë përkatëse, unë e hedh në votim propozimin konkret, përkatësisht propozimet e Ekzekutivit të Komunës dhe subjekteve të përfaqësuar në Kuvend, dhe atë:

dy drejtorët e propozuar nga Ekzekutivi i Komunës, përkatësisht, z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, dhe z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

z. Fatlume Jaha, e propozuar nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së,

z. Rafet Llapashtica, i propozuar nga Grupi i këshilltarëve të PDK-së, dhe

z. Bejtush Dushi, nga shoqëria civile, përfaqësues nga shoqata e pemëtarisë, i propozuar nga Kryetari i Komunës, konform legjislacionit përkatës.

z. Bahri Selimi, theksoi, nuk jemi kundër votimit dhe kundër këtyre procedurave, mirëpo nëse pengohet përfaqësimi i Lëvizjes Vetëvendosje në përbërjen e këtij komisioni, bëhet shkelje ligjore, e them këtë duke pasur parasysh që në fillim të mbledhje u tha se dy anëtarë duhet të jenë nga opozita e Kuvendit, ndërsa si duket zotëri Kryesues po harroni që ne jemi opozitë në këtë Kuvend, andaj kërkoj që të hedhën në votim dy përbërje të komisionit, përkatësisht propozimi të cilin po sa e bëre, dhe propozimi tjetër ku përfshihet edhe anëtari nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje. E them këtë duke u bazuar në të drejtën e çdo këshilltari të Kuvendit që të bëj propozime.

z. Nexhat Llumica, theksoi, pajtohem plotësisht me Lëvizjen Vetëvendosje për të hedhur në votim propozimin e tyre ngase kur ka propozime nga këshilltarët e Kuvendit, ato duhet të hedhën në votim.

z. Naim Çunaku, theksoi, sqarim, sa unë e lexova aktin të cilin e posedon drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, shkruhet kështu, dy anëtarë nga Kuvendi i Komunës, nuk përcaktohet pozitë – opozitë, dy nga Ekzekutivi i Komunës dhe një anëtarë nga shoqëria civile, pra është shumë e qartë. Ndërsa kush janë dy anëtarë të Kuvendit të Komunës është marrëveshje ndërmjet neve si subjekte të përfaqësuar në Kuvend.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, të drejtën e propozimeve e kanë të gjithë këshilltarët e Kuvendit, andaj zotëri Kryesues kërkoj nga ju t'i hedhni në votim secilin propozim që është bërë, të gjithë ne jemi në dijeni se nuk mund të mohohet kjo e drejtë dhe as që tentohet, por meqë nuk po pajtohen që të veprohet sipas legjislacionit përkatës, kërkoj që të hedhën në votim të gjitha propozimet veç e veç, dhe ai propozim që kalon me vota, kalon ai që nuk kalon mbetet vetëm propozim.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, opinioni im rreth kësaj çështjeje është se propozimi i dy drejtorëve të dy Drejtorive është nga Ekzekutivi i Komunës i cili është LDK, propozimi i z.Fatlume Jaha është nga LDK-ja dhe propozimi i anëtarit nga shoqëria civile është nga LDK, ndërsa PDK-së e cila e ka propozuar anëtarin e vet, si mbetet tjetër vetëm ta pranoj që të jetë vetëm sa për dekor në atë komision ngase shumica e anëtarëve të komisionit i mbetet LDK-së, mirëpo për të qenë më transparent propozoj që komisioni përkatës të përbëhej kështu, dy nga Ekzekutivi i Komunës, dy nga Kuvendi i Komunës, njëri të jetë nga PDK dhe tjetri nga LVV, dhe anëtar i pestë nga shoqëria civile. Pra edhe kështu shumica e anëtarëve do të ishte në favor të LDK-së, por që për ngritjen e këtij komisioni nuk do të paraqitet problem.

z. Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Inpeksionit, theksoi, konsideroj se nuk ka nevojë të bëhet gjithë kjo zhurmë rreth përbërjes së këtij komisioni ngase ne jemi në dijeni se jemi në sistemin demokratik ku parim i demokracisë është shumica, dhe në bazë të ligjit votohet publikisht nga këshilltarët e Kuvendit, andaj konsideroj se nuk ka nevojë të polemizojmë se a do të jetë e përfaqësuar në këtë komision PDK-ja apo LVV-ja. Unë kam pasur rastin të shoh edhe vendimin e Kuvendit të Komunës së Drenasit ku pozita është e përfaqësuar në këtë komision me katër përfaqësues, ndërsa opozita me një përfaqësues. Pra ligji dhe aktet nënligjore e përcaktojnë këtë përbërje të këtij komisioni dhe nuk kemi nevojë të humbasim kohë duke debatuar për këtë çështje ngase nuk e lejon legjislacioni përkatës atë që ju e pretendoni.

z. Haki Rudari, theksoi, parafolësi e përmendi Drenasin, por nuk jam në dijeni se a është në dijeni drejtori parafolës se në Drenas nuk ka Grupe të këshilltarëve përveç Grupit të PDK-së, ndërsa në Kuvendin e Komunës së Podujevës kemi tjetër situatë sepse kemi tri Grupe të këshilltarëve, andaj ky krahasim i bërë nga drejtori parafolës mendoj se nuk është i arsyeshëm. Meqë në komisionin përkatës parashihen dy anëtarë nga Ekzekutivi i Komunës dhe një anëtar nga shoqëria civile të cilin e propozon Kryetari i Komunës, do të ishte shumë e ndershme që në këtë komision të përfaqësohen dy anëtarë nga Grupet e ndryshme opozitare. Pra mendoj se do të ishte mirë që të pranohej propozimi që e bëri pak më parë kolegut z. Lutfi Rexhepi.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, meqë ligji e thotë se nëse paraqiten dy apo më shumë propozime, patjetër duhet të hedhën në votime, dhe nuk përmenden fare pozita dhe opozita, e kjo është mënyra më demokratike. Ndërsa neve tani na u paraqiten tri propozime dhe propozoj që të votohet me votim të fshehtë për tri propozimet.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, po e vërejë që nuk ka vullnet dhe që disponimi i pozitës është që të mbivotoi dhe të dominoi në çdo aspekt, andaj në rrethana të tilla unë deklarohej se për këtë çështje nuk e shoh të arsyeshme të marr pjesë më në këtë seancë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pas gjitha këtyre diskutimeve tani unë para vetës kam dy propozime të përpiluara të cilat dua t'i hedh në votim, njëri është propozimi i Grupit të këshilltarëve të LVV-së, ndërsa propozimi tjetër është ai të cilin e paraqita pak më parë.

z. Kadri Avdiu, theksoi, nuk më duket e kënaqshme që ne deri më tani debatuar për një komision i cili do të ketë për detyrë të shqyrtoj ankesat e palëve në procedurën e dhënies së pronave të Komunës në shfrytëzim. Meqë ligji nuk e përcakton përbërjen e këtij komisioni por vetëm Udhëzuesi, e përcakton përbërjen e komisionit përkatës, ashtu siç e ceku drejtori i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, unë kërkoj të gjendet një mirëkuptim, pasi që realisht nga Ekzekutivi i Komunës po caktohen tre anëtarë duke përfshirë edhe atë nga shoqëria civile, për të pasur transparencë në atë komision do të ishte mirë që dy anëtarët tjerë të jenë, njëri nga PDK, dhe njëri nga LVV.

z. Bahri Selimi, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje kërkojmë që të vendoset formula e propozuar nga z. Lutfi Rexhepi, konkretisht në kuadër të komisionit përkatës të përfshihen dy anëtarë nga opozita, përndryshe ne do ta sabotojmë votimi apo nuk do të marrim pjesë në procedurën e votimit.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë kemi dy propozime, unë nuk mund ta anashkaloj asnjërin.

Propozimi i parë është, përveç dy drejtorëve të Drejtorive përkatës edhe anëtarit nga shoqëria civile, anëtarë të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës, në kuadër të komisionit të jenë një anëtarë nga LDK, dhe një anëtarë nga PDK.

Propozimi i dytë është, përveç dy drejtorëve të Drejtorive përkatës edhe anëtarit nga shoqëria civile, anëtarë të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës, në kuadër të komisionit përkatës të jenë edhe dy anëtarë nga Kuvendi, përkatësisht, një nga PDK dhe një nga LVV. Pra këto dy propozime unë do ti hedh në votim.

Para se këto dy propozime t'iu nënshtrohen procedurës së votimit, lëshohet mbledhja nga Grupi i këshilltarëve të Lëvizjes Vetëvendosje, Grupi i këshilltarëve të Partisë Demokratike të Kosovës, dhe nga këshilltari nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Pasi që u konstatua se nuk ekziston kuorumi për punë, Kryesuesi i Kuvendit e konstaton të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 18:00

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-70650
Podujevë,
31 korrik 2014**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**